

Strategic Partnership for the Mediterranean Large Marine Ecosystem

Together for the Mediterranean Sea

MedPartnership



Plani i Menaxhimit të Integruar të Burimeve (PMIB) për Zonën e Bunës

PËRMBLEDHJE (Korrik 2015)



Redaktorë dhe autorët kryesore:

Dimitris Faloutsos, Marina Marković dhe Brian Shipman

Koordinatori kombëtar për Shqipërinë: Zamir Dedej

Pika fokale kombëtare për Malin e Zi: Jelena Knezević

Autorët e pjesës C “Menaxhimi i burimeve ujore: Analiza e situatës”:

Dimitris Faloutsos, Nikolaos Skoulikidis, Elias Dimitriou dhe Konstantinos Gritzalis

Autorë të studimeve tematike të përdorura për përgatitjen e Planit të Menaxhimit të Integruar të Burimeve:

Lavanya Anneboina, Irakli Beka, Hamdi Beshku, Vasilije Bušković, Zamir Dedej, Damiano Delrosso, Thanas Goga, Antonio Guarnieri, Fjoralba Hanxhari, Jadranka Kaludjerović, Đuro Karanikić, Genti Kromidha, Vesna Mačić, Anil Markanya (supervizim dhe mbështetje për studimin tematik mbi vlerësimin e rreziqeve nga ndryshimet klimatike), Miriam Ndini, Franka Paloka, Darko Pekić, Nadia Pinardi, Dragana Radević, Dragan Radojević, Valbona Smixiu, Tim Taylor dhe Jovana Vujačić

Rishikimi dhe kontribute për përgatitjen e masave: Matthew Lagod, Jelena Knežević, Andrea Merla, Michael Scoullou dhe Željka Škaričić

Redaktimi: David McDonald

Përkthimi në shqip: Esmeralda Subashi

Lista e figurave	4
Konteksti	1
Procesi i Përgatitjes së Planit të Integruar	3
Si duhet lexuar ky dokument	5
Qasja	5
PJESA A.....	7
1. Bazat e Planit - Krijimi i procesit.....	9
1.1 Shqyrtimi	9
1.2 Vizioni paraprak për zonën	11
1.3 Caktimi i Kufirit të Zonës Ndërkufitare.....	11
1.4 Qeverisja e procesit të përgatitjes së Planit.....	14
2. Analiza & E ardhmja	15
2.1 Analiza	15
2.2 Përmbledhja e Analizës	15
3. Formulimi i Vizionit	20
4. Hartimi i Planit- identifikimi i nxitësve, trysnive dhe ndikimeve.....	21
5. Hartimi i Planit- Objektivat e Planit.....	28
6. Realizimi i Vizionit	32
6.1 Masat	32
6.2 Aktivitetet prioritare	38

Lista e figurave

Figura 1: Vendndodhja e zonës së Planit Ndërkufitar të Lumit Buna	2
Figura 2: Procesi i Planifikimit i KMI-së	3
Figura 3: Ndarjet administrative të Zonës Ndërkufitare	12
Figura 4: Zona e planit.....	13
Figura 5: Cikli NPGJNR.....	21
Figura 6: Integrimi i nxitësve me fushat e politikave dhe objektivat dhe masat përkatëse të përdorura për arritjen e tyre.	31

Konteksti

Plani i Menaxhimit të Integruar shqyrton në tërësi ndikimet e veprimtarive që zhvillohen në rrjedhën e sipërme të basenit të lumit Buna mbi kushtet e zonës bregdetare në rrjedhën e poshtme dhe në vetë basenin e Bunës si edhe ndikimet e fushave kryesore të zhvillimit- bujqësisë, turizmit dhe zhvillimit urban- të zonës së zgjeruar bregdetare dhe zonës së pellgut ujëmbledhës, kryesisht në drejtim të disponueshmërisë dhe cilësisë së ujit. Në të njëjtën kohë, janë shqyrtuar edhe ndikimet bregdetare që vijnë nga ana e detit, si rezultat i ndërveprimit mes detit dhe ujërave të ëmbla, të ndikuara nga rrymat detare dhe episodet e kushteve të skajshme meteorologjike, që mund të kenë ndikim shumë të madh në deltën e lumit dhe akuiferet bregdetare. Prandaj, Plani paraqet integrimin e metodologjive të caktuara për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore (MIBU) dhe Menaxhimin e Integruar të Zonës Bregdetare (MIZB) në një “Kuahër Metodologjik Integruar” (KMI) të vetëm. Plani zbaton qasjen e ekosistemeve për menaxhimin e integruar të tokës, ujit dhe burimeve të jetesës që promovon ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të tyre në mënyrë të drejtë.

Plani synon gjithashtu edhe ndërthurjen optimale të këtyre qasjeve brenda zonës ndërkufitare të Shqipërisë dhe Malit të Zi (Figura 1), duke bashkuar kësaj strukturat administrative të të dy shteteve dhe lokaliteteve përkatëse të tyre. Lumi Buna¹, pellgu ujëmbledhës i tij, akuiferet kryesore dhe ujërat bregdetare sigurojnë fillin e përbashkët fizik që lidh dy vendet; një sistem hidrologjik që mbështet proceset natyrore dhe socio-ekonomike. Uji mund të konsiderohet si “sistemi i qarkullimit të gjakut” i natyrës dhe ekonomisë.

Rrjedhimisht zona bregdetare është hapësira ku ndodh ndërveprimi mes zonave tokësore dhe detare, tokës dhe detit.

Kuptimi i komponentëve të ndryshëm të këtij sistemi dhe ndërveprimeve ndërmjet tyre është i rëndësishëm për menaxhimin e qëndrueshëm të tij.

Kuaheri Ligjor/Institucional përbëhet nga rregulloret kombëtare dhe legjislativi përkatës i BE-së që është futur relativisht kohët e fundit në një përpjekje të të dyja vendeve që janë candidate për në Bashkimin Evropian, për përafrimin me legjislativin e BE-së (*acquis communautaire*). Në këtë drejtim, Direktiva Kuahër e Ujit e BE-së (DKU) është përfshirë dhe përdorur si ligj kuahër për menaxhimin e burimeve ujore. Plani përdor metodologjinë e DKU-së për planifikimin e menaxhimit të burimeve ujore; në këtë drejtim kjo është përpjekja e parë në të dyja vendet për zbatimin e kësaj kërkesë ligjore.

Kësaj Plani zbaton konsideratat e MIBU-së që përdorin kërkesat e DKU-së së bashku me MIZB-në për bashkërendimin dhe integrimin ndërsektorial, si edhe me bashkëpunimin ndërkufitar në planifikimin dhe menaxhimin e pellgjeve ujore dhe zonave bregdetare. Nxitësi i komponentit MIZB të Planit është Protokollin MIZB për Mesdheun- i hartuar si një instrument ligjor tej-shtetëror për të siguruar një kuahër ligjor të përbashkët për 21 vendet e Mesdheut dhe BE-në. Hyrja në fuqi e Protokollit në vitin 2011, dhe ratifikimi i tij nga Shqipëria dhe Mali i Zi tregojnë përkushtimin e vendeve ndaj zhvillimit të qëndrueshëm bregdetar. Gjithashtu, ratifikimi i Protokollit nga BE-ja, nënkupton që Protokollin është bërë tashmë pjesë e ligjit të BE-së me efekte detyruese mbi Vendet Anëtare dhe ato candidate.

Duke bashkuar instrumentet e politikave dhe metodologjitë nga disiplinat e MIBU-s (duke përfshirë menaxhimin e ujërave sipërfaqësore dhe atyre nënujore), planifikimin hapësinor, ndryshimin

¹ Buna është emri i të njëjtit lumë në Shqipëri dhe Bojana emri i lumit në Malin e Zi.

klimatik dhe MIZB-in, Plani po i shton vlerë qasjeve individuale si **“e tëra është më e madhe se sa shuma e pjesëve përbërëse”**.

Përvoja e marrë gjatë përgatitjes së planit të menaxhimit të integruar të lumit Buna do të përdoret për replikimin e përpjekjeve në zona të tjera të pellgut të Mesdheut në vend të përgatitjes së planeve të veçanta MIBU dhe MIZB.




Figura 1: Vendndodhja e zonës së Planit Ndërkufitar të Lumit Buna

Procesi i Përgatitjes së Planit të Integruar

Veçoria dalluese e këtij Plani është përdorimi i “Kuadrit Metodologjik Integruar” (KMI) i cili përfshin interesa të ndryshme sektoriale dhe kompleksitetet e administrimit të tyre. Në veçanti, qasja e integruar ndërthur shqyrtimin e çështjeve socio-ekonomike dhe fizike dhe propozon masa të unifikuara dhe reagimet ndaj tyre (Kutia 1).

Përfitimet e kësaj qasjeje të integruar janë potencialet për zgjidhjet fitoj-fitoj në të cilat trajtimi i problemeve të njërit sektor mund të sjellë përfitime për sektorë të tjerë, duke krijuar ekonomitë e shkallës nëpërmjet reagimeve të përbashkëta, së bashku me reduktimin e gjasave për konflikt ndërmjet interesave sektoriale, si në nivelin e menaxhimit të burimeve natyrore ashtu edhe në nivelin e planifikimit ekonomik. Qasja e integruar gjithashtu lehtëson shqyrtimin e çështjeve/ problemeve “ndërsektoriale” si ndryshimet klimatike dhe promovimi i mirëqenies ekonomike dhe sociale.

Plani është gjithashtu edhe ndërkufitar, duke përfshirë zona të Shqipërisë dhe Malit të Zi që ndahen nga Lumi Buna por që kanë të njëjtat karakteristika dhe probleme. Veçoritë e përbashkëta kryesore ndërkufitare natyrore dhe fizike përfshijnë lumin, pellgun ujëmbledhës dhe akuiferet e tij kryesore, së bashku me ekosistemin shoqëruar me habitatet dhe llojet e tij me vlerë të lartë. Zona gjithashtu ndan sfidat e ngjashme ekonomike dhe sociale të një bujqësie të dobët dhe në rënie, rritjen e shpejtë por të pakontrolluar të zhvillimit të bregdetit dhe turizmit, të ardhura shumë të ulëta, dhe mungesën e investimeve në infrastrukturë. Gjithashtu, zona ndërkufitare ndan edhe rreziqet që përfshijnë përmytjet katastrofike, ndotjen dhe ndikimet e ndryshimeve klimatike. Plani fokusohet pikërisht tek këto probleme të përbashkëta.

Ndërthurja e KMI-së dhe qasjeve ndërkufitare ofron mundësi për zhvillimin e mirëkuptimit të përbashkët, për identifikimin e çështjeve/

problemeve apo interesit të përbashkët dhe, atje ku është e përshtatshme, për ndarjen e prioriteteve dhe bashkërendimin e përpjekjeve për adresimin e këtyre problemeve. Qasja ndërkufitare është gjithashtu në kohë teksa të dyja vendet po lëvizin drejt aderimit në BE çka promovon dhe mbështet një bashkërendim ndërkufitar më të fuqishëm.

Udhërrëfyesi i KMI-së përbëhet nga pesë faza bazë sikurse jepet në diagramin e paraqitur (Figura 2). Ai është projektuar më shumë të udhëzojë sesa të diktojë, dhe mund të përshtatet ndaj rrethanave lokale individuale.




Figura 2: Procesi i Planifikimit i KMI-së

Kutia 1: Udhëzimet Metodologjike Integruese

(Burimi: Një Kuadër metodologjik Integruës për menaxhimin e bregdetit, basenit të lumit dhe akuifereve: Drejt Qasjeve Konvergjuese të Menaxhimit të Zonave Bregdetare të Mesdheut (GWP-Med; PAP/RAC dhe UNESCO-IHP; 2015)

Brenda një nisme të përbashkët, si pjesë e projektit MedPartnership, Programi i Veprimeve Prioritare/ Qendra e Veprimtarive Rajonale (PAP/RAC), Programi Hidrologjik Ndërkombëtar (IHP) i UNESCO-s dhe Partneriteti Global i Ujit-Mesdhetar (GWP – Med) propozuan një Kuadër të plotë të Menaxhimit Integruës (KMI) si metodologji operative për menaxhimin e qëndrueshëm të vazhdimësisë ekologjike që përbëhet nga zona bregdetare, baseni i lumit dhe akuiferet bregdetare. Kuadri i inkurajon dhe i ndihmon planifikuesit, prakticienët dhe palët e interesuara drejt një përdorimi të përbashkët, efikas dhe efektiv të burimeve relativisht të kufizuara. KMI-ja ka për synim mbështetjen e bashkërendimit, integritit më të mirë dhe përfshirjes më të madhe të të gjitha grupeve të interesit në të gjitha fazat e procesit të vendimmarrjes. Gjithashtu, ai e integron ndryshimin klimatik si një çështje ndër sektoriale të rëndësishme për proceset e planifikimit dhe zbatimit në zonën bregdetare.

Si duhet lexuar ky dokument

Dokumenti i mëposhtëm përbëhet nga katër pjesë kryesore:

- **Pjesa A** paraqet në mënyrë të përmbledhur procesin e formulimit të Planit, analizën, nëpërmjet projektimit të masave dhe veprimeve për zbatimin e Planit. Fazat janë përmbledhur sipas kuadrit me pesë faza të krijuar nga “Kuadri Metodologjik Integruar” (KMI).

Pjesa A përmban gjithashtu edhe masat e planit dhe aktivitetet prioritare.

- **Pjesa B** paraqet të dhënat bazë dhe informacionet e hollësishme, si edhe analizën e sektorëve dhe temave përkatëse të Planit, së bashku me çështjet kryesore të përmbledhura në pika.
- **Pjesa C “Menaxhimi i Burimeve Ujore - Analiza e Gjendjes** së burimeve ujore mund të lexohet si një dokument “më vete” për të përmbushur kërkesat statutorë të Direktivës Evropiane Kuadër të Ujit.

Të dhëna dhe informacione të tjera, si Analiza e Grupeve të Interesit, Kuadri Institucional dhe Ligjor, dhe tabelat e hollësishme NPGJNR paraqiten tek shtojcat.

Qasja

Ky Plan Menaxhimi Ndërkufitar i Bunës është një zbatim pilot “në botën e vërtetë” të “Procesit të Integruar Metodologjik” (PIM).

Për të strukturuar analizën e ndërveprimit kompleks ndërmjet fushave kryesore dhe për ta lidhur atë me politikën e sugjeruar dhe masat e integruara me planifikimin është përdorur kuadri "NPGJNR". NPGJNR nënkupton: Nxitësit – Trysnitë- Gjendja- Ndikimi- Reagimet (më shumë informacion jepet në kreun 4).

Plani është gjithashtu i rëndësishëm edhe si një test i punës në nivel ndërkufitar. Kjo punë ndërkufitare paraqet sfida të rëndësishme për afatin kohor të planit. Vlerësimi duhet të lejojë një periudhë realiste për së pari: nevojën për harmonizimin e të dhënave dhe hartëzimin ndërmjet dy vendeve duke përfshirë edhe të dhënat socio-ekonomike dhe paraqitjen në hartë të ujërave nëntokësore. Së dyti, nevoja për mbledhjen e të dhënave bazë, për shembull nevoja për zhvillimin e karakterizimit të statusit ekologjik si pikë referimi.

PJESA A

1. Bazat e Planit - Krijimi i procesit

Detyrat kryesore në këtë fazë ishin krijimi i mekanizmit praktik për procesin e përgatitjes së Planit.

1.1 Shqyrtimi

Shqyrtimi është vlerësimi paraprak i nxitësve kryesorë që qëndrojnë pas Planit. Këta përfshijnë nxitësit e politikave si Konventa e Barcelonës dhe protokollin i saj MIZB që ofrojnë një kuadër të përbashkët ligjor për promovimin dhe zbatimin e MIZB-së, duke përfshirë edhe zona bregdetare ndërkufitare si Buna.

Të dyja vendet aspirojnë të anëtarësohen në BE dhe kanë marrë statusin e vendit kandidat; Mali i Zi ka përparuar më shumë, duke nisur negociatat zyrtare të anëtarësimit. Anëtarësimi i ardhshëm në BE është një nxitës kryesor politik teksa procesi përfshin miratimin, vënien në zbatim dhe kontrollin e zbatimit të ligjit të BE-së, si edhe zbatimin e reformave gjyqësore, administrative, ekonomike dhe reformave të tjera të nevojshme që vendet të përmbushin kushtet dhe kriteret e anëtarësimit. Këto përfshijnë sektorët e ujit, mbetjeve dhe ajrit. Gjithashtu, që të dyja vendet kanë aspirata për zhvillim ekonomik të fuqishëm, për t'i sjellë qytetarët e tyre më afër rregullave dhe normave evropiane.

Plani është një tregues i qartë i gatishmërisë politike të të dyja vendeve për të bashkëpunuar në lidhje me çështjet ndërkufitare. U përdor një analizë e shkurtër e informacioneve bazë dhe dialogu i hershëm me grupet e interesit për të përcaktuar:

- Çështjet/ problemet dhe shqetësimet kryesore;
- Hollësitë praktike të përgatitjes së planit;
- Vizionin paraprak për zonën.

Çështjet dhe shqetësimet kryesore

Para periudhës së shqyrtimit u bë identifikimi i çështjeve/problemeve kryesore; gjetjet janë përmbledhur në analizën SWOT të zonës së Planit

më poshtë. Problemet paraqiten me hollësi në Pjesën B, dhe janë përmbledhur sipas kategorive të gjera: trysnitë mbi vlerat natyrore, buxheti i ujit, ndryshimet klimatike, çështjet hidro-morfologjike, ndotja dhe sfidat socio-ekonomike dhe të zhvillimit.

Hollësitë praktike të përgatitjes së planit

Puna ndërkufitare, veçanërisht kur kufiri është një lumë dhe grykëderdhja e tij ndan komunitete, kultura dhe kombësi, i shton kufizime të dukshme praktike procesit të përgatitjes së planit. Në kohën e përgatitjes së planit, të dyja vendet kishin kuadro të ndryshëm legjislativë dhe administrativë.

Administratat vendore në Shqipëri në Plan përbëhen nga komunitete të vogla zakonisht prej disa pak qindra banorësh brenda qarkut të gjerë të Shkodrës me një popullsi mbi 200.000 banorë. Në Malin e Zi, niveli më i ulët i administratës është Bashkia; e vetmja administratë vendore të zonën e Planit është Ulqini me popullsi afërsisht 20.000 banorë. Sa i takon vitit 2015, në Shqipëri do të zbatohet organizimi i ri administrativ që nuk parashikon më komunitat si njësitë më të vogla administrative. Sidoqoftë, ky ndryshim nuk kishte ndodhur gjatë procesit të përgatitjes së planit dhe kësaj nuk u pasqyrua në vlerësimin socio-ekonomik.

Shqyrtimi theksoi shqetësime të tjera praktike, jo më pak mungesën dhe nevojën për të mbledhur dhe/ose prodhuar të dhëna të reja. Një shembull i rëndësishëm është kërkesa për Karakterizimin e Statusit Ekologjik, për herë të parë për Malin e Zi dhe Shqipërinë, si një pikë referimi. Nevoja të tjera përfshijnë identifikimin e ndryshimeve në serinë e të dhënave ndërmjet dy vendeve dhe harmonizimin e tyre (shihni për shembull mungesën e hartëzimit të ujërave nëntokësore, dallimet në llojin e të dhënave socio-ekonomike, etj.) Përpjekja për kapërcimin e këtyre problemeve solli një shtyrje të konsiderueshme të kuadrit kohor të Planit në fazat e hershme të tij.

Tabela 1: Tabela e analizës SWOT nga raporti i Vlerësimit për zonën e Bunës

Pikat e forta	Pikat e dobëta
<p><u>Mjedisi</u></p> <ul style="list-style-type: none"> Biodiversitet i pasur, me rëndësi të veçante për shpendët shtegtare dimërues Ka një ndërgjegjësim mbi nevojën për të ruajtur vlerat natyrore për të ardhmen, ka burime njerëzore lokale për menaxhimin e mjedisit <p><u>Faktorët socio ekonomike</u></p> <ul style="list-style-type: none"> Potenciale të rëndësishme për zhvillimin ekonomik lidhur me ekoturizmin (dhe shërbimet që lidhen me të), bujqësinë Identitet kulturor i ruajtur (edhe pse nën presion), mënyra tradicionale jetese <p><u>Kuadri ligjor e institucional</u></p> <ul style="list-style-type: none"> Harmonizimi i Legjislacionit të BE për një sere fusha është në vazhdim Angazhim i përgjithshëm për zhvillimin e qëndrueshëm në dokumentet politike <p><u>Bashkëpunimi ndërkufitar</u></p> <ul style="list-style-type: none"> Fusha e bashkëpunimit ndërkufitar po zgjerohet Mekanizma për menaxhimin e përbashkët të burimeve të përbashkëta natyrore po përgatiten. Burime të reja financimi po behën të disponueshme 	<p><u>Mjedisi</u></p> <ul style="list-style-type: none"> Kontroll jo i duhur mbi ndotjen kryesisht ndotjen e ujerave (nga zhvillimi urban dhe turizmi, lundrimi dhe hedhja e mbeturinave Ka humbje të biodiversitetit –shkatërrim habitatesh dhe pakësim të numrit të llojeve Mjedisi shpesh nuk është prioritet në hartimin dhe zbatimin e planeve të zhvillimit hapësinor Menaxhimi i rreziqeve natyrore (ndryshime klimatike, përmytje, tërmete, ekstreme të motit, erozioni) <p><u>Faktorët socio ekonomike</u></p> <ul style="list-style-type: none"> Cilësia e ofertës turistike është e pakënaqshme –kulme sezonale afatshkurta vizituesh dhe shfaqje të karakteristikave të turizmit masiv <p><u>Infrastruktura</u></p> <ul style="list-style-type: none"> Infrastruktura e pazhvilluar transporti dhe mjedisore, probleme me furnizimin me energji Kapacitetet për të tërhequr fonde dhe menaxhuar infrastrukturën janë të kufizuara <p><u>Kuadri ligjor dhe institucional</u></p> <ul style="list-style-type: none"> Zbatim i dobët i ligjeve Kapacitete të pamjaftueshme institucionale, përfshirë koordinimin midis institucioneve të rëndësishme, politikave sektoriale dhe niveleve të ndryshme të qeverisjes <p><u>Bashkëpunimi ndërkufitar</u></p> <ul style="list-style-type: none"> Marrëveshjet formale të bashkëpunimit nuk ndiqen gjithmonë nga masa operative Planifikimi i zhvillimit nuk koordinohet fare Lidhje të dobëta infrastrukturore
<p>Mundësitë</p> <p><u>Mjedisi</u></p> <ul style="list-style-type: none"> Përafrimi me standardet e BE dhe fuqizimi i zbatimit për të përmirësuar cilësinë mjedisore janë prioritet të axhendes së integritit në BE <p><u>Faktorët socio ekonomike</u></p> <ul style="list-style-type: none"> Mbështetje ndërkombëtare dhe nga BE për zhvillimin e qëndrueshëm të zonës Ka mbështetje për inovacion zhvillimin e ekonomisë mbi bazën e njohurive dhe konkurrencës Ka interes nga turistët e huaj në vlerat natyrore dhe kulturore të zonës <p><u>Infrastruktura</u></p> <ul style="list-style-type: none"> Burime të favorshme financimi po behën të mundshme (p.sh., fondet IPA) <p><u>Kuadri ligjor dhe institucional</u></p> <ul style="list-style-type: none"> Integrimi evropian (si mjet për të ngritur nivelin e sistemit ligjor dhe institucional) Efekte sinergjike të përqasjeve të integruara në menaxhimin e aktiviteteve njerëzore Arritje e konsensusit <p><u>Bashkëpunimi ndërkufitar</u></p> <ul style="list-style-type: none"> Donatorët ndërkombëtarë favorizojnë bashkëpunimin ndërkufitar, veçanërisht në fushën e mjedisit dhe transportit 	<p>Kërcënimet</p> <p><u>Mjedisi</u></p> <ul style="list-style-type: none"> Pasojat e rreziqeve mjedisore (veçanërisht përmytjeve) rriten si pasojë e ndryshimeve klimatike Menaxhimi i papërshtatshëm i mbajtjeve dhe ujerave të zeza vazhdon dhe ul atraktivitetin e zonës Mungesa investimesh në menaxhimin e burimeve natyrore <p><u>Faktorët socio-ekonomike</u></p> <ul style="list-style-type: none"> Goditjet ekonomike nga jashtë dhe krizat e reja potenciale ndikojnë zhvillimin lokal Turizmi është një sektor i ekonomisë shumë i ndjeshëm nga tkurrjes ekonomike Ndikimet e ndryshimeve klimatike në ekonomi <p><u>Infrastruktura</u></p> <ul style="list-style-type: none"> Mungesa e fondeve pengon zhvillimin e mëtejshëm <p><u>Kuadri ligjor dhe institucional</u></p> <ul style="list-style-type: none"> Pamundësia për të zbatuar ligjet dhe politikat është e tej zgjatur, mos vazhdueshmëri e reformave institucionale Ndryshime në prioritetet politike <p><u>Bashkëpunimi ndërkufitar</u></p> <ul style="list-style-type: none"> Zbatimi i marrëveshjeve dypalëshe behet në mënyrë joefektive Vendet nuk arrijnë të kapitalizojnë rezultatet e projekteve të mbështetura nga ndërkombëtarët (p.sh., projekti i Bankës Botërore për liqenin e Shkodrës)

1.2 Vizioni paraprak për zonën

Versionet paraprake të “vizionit” për zonën e Planit u paraqitën në Raportin e Shqyrtimit dhe u diskutuan me grupet e interesit në takimin “e hershëm” për harmonizimin.

Alternativat e propozuara për deklaratën e misionit ishin si më poshtë:

“Planifikim i integruar për të bashkuar njerëzit nga të dyja anët e lumit Buna, për të përmirësuar jetesën dhe ruajtur vlerat unike ekologjike dhe veçantinë e zonës”;

“Planifikim i integruar për të ardhmen evropiane të rajonit të Bunës: duke lidhur njerëzit- duke përmirësuar jetesën- duke zhvilluar kapacitete- duke ruajtur vlerat unike ekologjike dhe veçantinë e zonës”.

“Përmirësimi i cilësisë së jetës së të gjithë qytetarëve të lumit Buna dhe zonës bregdetare nëpërmjet një mekanizmi të qartë të planifikimit dhe zhvillimit të turizmit duke pasur parasysh mbrojtjen dhe pasurimin e vlerave të biodiversitetit”.

Grupet e interesit të pranishme në takim, shprehën mbështetjen për zhvillimin e ardhshëm të zonës që parashikon zhvillimin e këtyre llojeve të turizmit që mbështeten në mbrojtjen e natyrës, si ekoturizmi. Diskutimet e ndërthurura me rezultatet e konsultimeve me ekspertët kryesorë kombëtarë dhe Analizën e Grupeve të Interesit (2012) rezultuan në versionin përfundimtar të Vizionit të formuluar në seksionin 3 më poshtë.

1.3

Caktimi i Kufirit të Zonës

Ndërkufitare

Kufiri caktohet në bazë të KMI-së që përfshin udhëzimet në Protokollin e MIZB-së; ato të BE WFD-së dhe qasjes së sistemeve. Konsideratat e mësipërme shqyrtojnë të gjitha karakteristikat natyrore të zonës dhe kushtet lokale. Një zonë Ndërkufitare përbëhet nga elemente ndërkufitare

natyrore d.m.th. zona bregdetare, pellgu ujëmbledhës, akuiferet, ujërat tranzitore dhe bregdetare (deri në kufirin e jashtëm të detit territorial) dhe administratat përkatëse (Figura 3).

Duke u mbështetur në sa më sipër, ekipi i planifikimit përdori kriteret e mëposhtme për të përcaktuar zonën bërthamë:

- Zona duhet të përfshijë ndërveprimet ndërkufitare dhe ato tokë-det;
- Duke ndjekur qasjen e ekosistemeve, kufijtë e zonës së caktuar duhet të marrin parasysh dhe të përkohjnë atje ku është e mundur me kufijtë e:
 - sistemeve të mjedisve natyrore në brendësi d.m.th. pellgu ujëmbledhës, ekosistemet, etj.;
 - zonës detare që ndër vepron drejtpërdrejt me mjedisin e brendshëm natyror dhe të krijuar nga njeriu d.m.th. zona ngjitur me tokën që ndikohet drejtpërdrejt nga veprimtaritë që zhvillohen në tokë ose nga rrjedha e ujërave të ëmbla sipërfaqësore dhe nëntokësore;
- Kufijtë e zonës së caktuar duhet të marrin parasysh dhe të përkohjnë sa më shumë të jetë e mundur me ato të ndarjeve administrative për:
 - bashkitë, komunat, etj.;
 - menaxhimin e burimeve ujore d.m.th. pellgjet ujëmbledhëse.

Akuiferet kryesore shtrihen përtej kufijve të pellgut ujëmbledhës. Zona përtej kufijve të pellgut ujëmbledhës nuk u përdor për përcaktimin e zonës bërthamë meqë masat e parashikuara për këtë zonë do të ishin nën përgjegjësinë e autoriteteve të ndryshme të pellgut ujëmbledhës.

Duke u mbështetur në konsideratat e mësipërme, Plani fokusohet në një zonë bërthamë kufiri i së cilës tregohet në Figurën 4 më poshtë.

Në terma praktikë, kufiri tokësor i zonës së Planit është vizatuar duke përdorur kufijtë administrativë vendorë që përputhen gjerësisht me kufirin fizik të pellgut ujëmbledhës- duke lehtësuar në këtë



Figura 3: Ndarjet administrative të Zonës Ndërkufitare

mënyrë analizën e mjedisit natyror dhe fizik së bashku me informacionin e disponueshëm socio-ekonomik. Në Malin e Zi kjo përfshin bashkinë e Ulqinit, ndërsa në Shqipëri kjo përfshin katër komuna brenda qarkut të Shkodrës (Ana e Malit, Bërdicë, Dajç dhe Velipojë). Janë futur edhe një pjesë e vogël e bashkisë së Tivarit dhe pjese te komunave Balldren i ri, Bushat dhe Rrethina, meqë ato përfshihen në pellgun ujëmbledhës të Bunës.

Zona detare është vizatuar sipas një vlerësimi të ndikimit parësor të rrjedhës së ujërave

sipërfaqësore në ujërat e brendshme detare siç tregohet nga niveli i kripësisë dhe, si një tregues tjetër i ndikimeve kryesore të veprimtarive që zhvillohen në tokë.

Plani identifikon çështjet/problemet e menaxhimit që lidhen me sfidat kryesore si edhe kushtet e tyre që konsiderohen si prioritet në nivel kombëtar dhe ndërkufitar dhe propozon masat e duhura për adresimin e tyre.




Figura 4: Zona e planit

1.4

Qeverisja e procesit të përgatitjes së Planit

Detyrat kryesore të kësaj faze: Bashkërendimi dhe përfshirja ndër sektoriale e grupeve të interesit, mbështetja teknike për Procesin, dhe komunikimi mes partnerëve. Për zonën e Bunës këto mekanizma përfshijnë elementet e mëposhtme:

1. Ngritja e Grupit Integruar të Punës (GIP): misioni i të cilit ishte:

Integrimi i veprimtarive të lidhura me metodologjitë dhe në veçanti ato që kanë të bëjnë me Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore duke përfshirë menaxhimin e akuifereve, dhe Menaxhimin e Integruar të Zonës Bregdetare, për të:

- Analizuar metodologjitë përkatëse, konvergencat e mundshme dhe rezultatet.
- Bashkëpunuar në hartimin e Kuadrit Metodologjik Integruar (KMI) që do të zbatohet në mënyrë eksperimentale në Planin e menaxhimit të Bunës.
- Udhëzuar dhe mbështetur partnerët përkatës (UNESCO- IHP, GWP Med, PAP RAC, SPA RAC) në zbatimin e menaxhimit të Bunës për arritjen e rezultateve të konsoliduar.
- Paraqitur KMI-në dhe përvojën e fituar.
- Arritur vlerën universale të KMI-së që do të mundësonte replikimin e saj gjetkë në Mesdhe dhe më gjerë.

2. Takime të përbashkëta të ekspertëve kombëtarë (shqiptarë dhe malazezë) dhe ndërkombëtarë, për të:

- Paraqitur gjetjet kryesore.
- Identifikuar aspektet problematike dhe çështjet/problemet që mund të dalin.
- Rënë dakord në lidhje me aspektet kritike.
- Përcaktuar udhërrëfyesin e ardhshëm dhe mënyrat e operimit.

3. Takimet dhe konsultimet e zhvilluara me grupet lokale të interesit që përbëheshin nga ekspertë teknikë, përfaqësues të administratave vendore dhe kombëtare, komunitetet vendase dhe OJF-të. U organizuan dy seminare me grupet e interesit në nivel ndërkufitar:

- Në fillim të procesit për të:
 - Vleftësuar situatën bazë sa i takon çështjeve/problemeve kryesore të përbashkëta të identifikuar në basenin e lumit dhe zonën bregdetare me anë të raportit të shqyrtimit;
 - Diskutuar vizionin e përbashkët për menaxhimin e zonës.
- Në fund të procesit për të:
 - Diskutuar gjetjet e Planit të menaxhimit dhe rënë dakord në lidhje me masat e ardhshme dhe veprimet prioritare të nevojshme për përmirësimin e gjendjes mjedisore, ekologjike dhe socio-ekonomike të zonës deri në vitin 2030.
 - Rënë dakord mbi mënyrat më të mira të operimit për përmirësimin e qeverisjes ndërkufitare dhe bashkëpunimit mes dy palëve.

U organizuan gjithashtu ndërkohë disa diskutime në grupe fokusi me komunitetet vendase në të dyja vendet, për hartëzimin dhe hulumtimin/analizimin e perceptimeve të grupeve të interesit në lidhje me çështjet/problemet e menaxhimit në zonë dhe mënyrën e adresimit të tyre.

2. Analiza & E ardhmja

Detyrat kryesore të kësaj faze: krijimi i bazës për veprimet e ardhshme, vleftësimi i çështjeve dhe problemeve nëpërmjet një analize dhe shqyrtimi më rigoroz, dhe përshkrimi i “Gjendjes” aktuale dhe i prirjeve të mundshme në të ardhmen.

E ndërthurur me mekanizmat e bashkërendimit të përshkruar më sipër, ajo hedh themelet për bashkëpunimin dhe zbatimin e ardhshëm.

2.1 Analiza

Analiza e hollësishme e gjendjes aktuale, problemet dhe çështjet e zonës janë strukturuar rreth fushave të mëposhtme tematike:

Këto shtjellohen me hollësi në Pjesën B, Historiku/Sfondi. Kufizimet e këtyre të dhënave dhe informacioneve janë referuar në seksionin e shqyrtimit më sipër.

2.2 Përmbledhja e Analizës

Në përgjithësi, ka mangësi në nivelin e të dhënave dhe informacionit me sa duket në të gjitha fushat e politikave për shkak të mungesës së kapacitetit për monitorim. Kjo situatë ndërlikohet nga gjeografia politike e zonës- që përfshin dy administrata kombëtare.

Sidoqoftë, ka disa probleme që dalin nga analiza e shtjelluar në Pjesën B të këtij dokumenti. Këto ndahen në kategoritë e mëposhtme dhe janë përmbledhur si më poshtë:

1. Karakteristikat Sociale dhe Administrative
2. Potenciali ekonomik
3. Mjedisi dhe Burimet Natyrore (duke përfshirë biodiversitetin dhe zonat e mbrojtura, hidrologjinë, proceset detare dhe bregdetare dhe përcaktimin e trupave ujorë)
4. Çështjet dhe problemet kryesore duke përfshirë:

- Çështjet natyrore dhe hidro-morfologjike (duke përfshirë ndryshimin klimatik)
- Ndotjen dhe statusin e Trupave Ujorë

5. Çështjet socio-ekonomike dhe ato të zhvillimit
6. Kuadri Institucional dhe Legjislativ

Nga analiza janë identifikuar karakteristikat e mëposhtme të zonës, të cilat janë të rëndësishme për menaxhimin e saj

Rëndësia e Ujit

Sistemi hidrologjik i zonës ka rëndësi të veçantë në proceset dhe funksionet socio-ekonomike. Uji mund të shihet si “sistemi i qarkullimit të gjakut” i natyrës dhe ekonomisë, dhe hidrologjia si sistemi vaskular/i enëve të gjakut nëpërmjet të cilit “transportohen” efektet pozitive dhe negative duke lejuar kësajsoj ndërveprimin ndërmjet komponentëve natyrorë-ekonomikë-hapësinorë, duke përfshirë edhe zonën detare. Pastaj, funksionet dhe proceset në zonën detare ndikojnë në zonën tokësore.

Lumi i Bunës është i shkurtër, vetëm 44 km. Kjo gjatësi e vogël e tij bie ndesh me rëndësinë e lumit. Me një shkarkim mesatar vjetor afërsisht prej 20km³/vit, prurja e lumit është shkarkimi i tretë më i madh në Mesdheun evropian pas atyre të lumenjve Rone dhe Po.

Kuptimi i komponentëve të ndryshëm të këtij sistemi hidrologjik dhe ndërveprimit mes tyre është i rëndësishëm për menaxhimin e qëndrueshëm të tij.

Ka një problem të veçantë me vlerësimin e rreziqeve të ujërave nëntokësore teksa vlerësimi i përgjithshëm i trupave të ujërave nëntokësore nuk është i mundur aktualisht për shkak të pothuajse mungesës së plotë të të dhënave të nevojshme. Sidoqoftë, duket se ka një rënie të nivelit të ujërave nëntokësore dhe ndoshta edhe përkeqësim të cilësisë së tyre.

Në lidhje me **standardet e kërkuara nga Direktiva Evropiane Kuadër e Ujit** gjetjet mund të përmbliken si më poshtë; duhet të theksohet se të dhënat e përdorura për karakterizimin e trupave ujorë kryesisht u gjeneruan nga projekti, dhe seritë e të dhënave të disponueshme nuk janë të mjaftueshme për përcaktimin e prirjeve të cilësisë:

- Statusi biologjik i trupave ujorë sipërfaqësorë ku të dhënat ishin të disponueshme u vlerësua si i dobët.
- Statusi kimik i Lumit Buna është “më pak se mirë” dhe kjo sjell që statusi i përgjithshëm i tij të karakterizohet si i keq.
- Në pak raste janë regjistruar ndotje nga metalet e rënda dhe përqendrimet mesatare të disa metaleve janë mbi Standardet Mjedisore të Cilësisë në një ose më shumë stacione të marrjes së mostrave.
- Cilësia kimike dhe fiziko-kimike e Lumit Buna përkeqësohet nga burimi tek grykëderdhja e tij, duke variuar nga mesatare në e dobët.
- Vëmendje e veçantë duhet t’i kushtohet adresimit të çështjes së llojeve invazive.
- Cilësia ekologjike e ujërave të zonës bregdetare është klasifikuar si e keqe.

Marrëdhënia e zonës së Planit me pellgun e zgjeruar ujëmbledhës dhe zonën detare

Lumi Buna buron nga Liqeni i Shkodrës- liqeni më i madh në Ballkan- dhe bashkohet me ujërat e basenit të Drinit me një sipërfaqe totale prej 21,000 km². Regjimi hidrologjik i Drinit është ndryshuar shumë si pasojë e ndërtimit të një kaskade digash. Si rezultat gjatë periudhave të rritjes së nivelit të ujit, Drini futet në Liqenin e Shkodrës ose kufizon rrjedhjen nga liqeni, duke shkaktuar rrjedhimisht shpesh përmytje. Gjithashtu, regjimi i prishur i shpërndarjes së sedimenteve dhe ekuilibri i sedimenteve- ekziston një efekt i kombinuar i mbajtjes së sedimenteve tek digat dhe dukuria në rritje e erozionit poshtë digave- ndikojnë mbi dinamikën bregdetare në një mënyrë komplekse. Gjithashtu, veprimtaritë ekonomike dhe proceset natyrore (p.sh. rrjedhat/rrymat) në ujërat

bregdetare lejojnë ndërveprimin me zonat detare në veri, jug dhe perëndim të zonës në fokus.

Menaxhimi i paqëndrueshëm i mbetjeve të ngurta dhe të lëngshme ushtron trysni mbi sistemin natyror. Industria dhe nxjerrja e mineraleve shkaktojnë ndotjen e pellgjeve ujëmbledhëse të Lumit Drin dhe Liqenit të Shkodrës dhe më pas ndikojnë edhe mbi pellgun ujëmbledhës të Lumit Buna.

Ndryshimet klimatike dhe rreziqet e mëdha

Ndryshimet e mundshme klimatike përfshijnë rritjen e nivelit të detit, që do të ketë efekte të konsiderueshme veçanërisht në lagunat dhe grykëderdhjet bregdetare. Me rritjen e kripësisë, mund të ketë zhvendosje në natyrën e ekosistemeve. Incidentet e skajshme dëmtuese ka të ngjarë të shtohen. Ka rrezik në rritje të përmytjeve. Frekuenca dhe intensiteti i përmytjeve është rritur- dy incidente përmytjesh në vitin 2010 ishin më të rëndat të regjistruara në 80 vitet e fundit- me dëme të konsiderueshme të ndërtesave dhe tokës bujqësore.

Ndikimet e prirjeve socio-ekonomike

Në sipërfaqe, të dhënat demografike tregojnë një model kontrastues ndërmjet dy vendeve- një rënie në Malin e Zi në krahasim me rritjen në Shqipëri. Sidoqoftë, statistikat shqiptare të bazuara në regjistrimin e votuesve, mund të fshehin një prirje të migrimit të jashtëm që ndjek prirjen kombëtare të migrimit në zonat urbane apo jashtë shtetit në kërkim të mundësive më të mira arsimore dhe ekonomike.

Dendësia relativisht e lartë e popullsisë në zonën e planit pasqyron një model të përgjithshëm të rënies në zonat rurale të brendshme. Dhe brenda vetë zonës së Planit ka një prirje të qartë të lëvizjes drejt shiritit/rripit bregdetar larg nga zonat e brendshme rurale. Nëse nuk do të ketë një ndryshim të madh të mundësive ekonomike dhe arsimore, nuk ka gjasa që këto prirje të ndryshojnë kah.

Migrimi jashtë i ndërthurur me reduktimin e veprimtarive industriale, si pasojë e tranzicionit në

ekonominë e tregut ka sjellë ndikime të reduktuara antropogjenike mbi mjedisin. Sidoqoftë, stabiliteti më i madh politik dhe ekonomik i kohëve të fundit ka çuar drejt rihapjes së shumë industrive potencialisht ndotëse në rrjedhën e sipërme të lumit duke përfshirë nxjerrjen e mineraleve, prodhimin e plehrave kimike dhe lëkurëve, si edhe rritjen e popullsisë në qendrat urbane. Teksa disa prej këtyre industrive kanë impiante trajtimi për ujërat e ndotura, shumë prej tyre janë prishur.

Një trysni e madhe në pellgun ujëmbajtës të Bunës është rritja e popullsisë gjatë verës. Afërsisht 400.000 turistë në vit vizitojnë zonën e Planit duke arritur pikën kulmore gjatë verës kur popullsia e zonës rritet pothuajse 6,5 herë.

Urbanizimi dhe Planifikimi

Procesi i urbanizimit në zonat bregdetare është intensifikuar nga vitet 1960 dhe në vazhdim, veçanërisht pas viteve 1990. Modeli i urbanizimit në zonën e planit karakterizohet nga zhvillimi i shpejtë në kohët e fundit i një rripi të ngushtë toke 5 km larg nga bregu i detit, dhe në përgjithësi ka natyrë lineare përgjatë bregdetit dhe autostradave (litorizimi).

Në Malin e Zi ka një mbi-ofertë të konsiderueshme të tokës së caktuar për ndërtim, plane urbane që alokojnë tokë të mjaftueshme për të strehuar një popullsi disa herë më të madhe se ajo ekzistuese. Një nga rezultatet e këtij planifikimi jo të qëndrueshëm është shpërhapja pa kriter e ndërtimeve, duke sjellë degradimin e peizazhit.

Zhvillimi në Shqipëri është karakterizuar nga mungesa e planeve formale dhe zhvillimi informal në një bum ndërtimesh në kohët e fundit që daton nga vitet 1990, veçanërisht në zonat bregdetare dhe qendrat urbane. Kontrolli i zbatimit të ligjit të ndërtimeve, dhe zbatimi i planeve të miratuara hapësinore është i pamjaftueshëm.

Në mungesë të një sistemi planifikimi të fuqishëm dhe efektiv dhe reduktimit të tokës për ndërtim, norma e urbanizimit mund të pritët të luhatet

gjërësisht sipas faktorëve spekulativë të turizmit dhe tregut dhe jo në bazë të prirjeve demografike.

Mjedisi natyror/ Biodiversiteti – jeta e egër

Pamjaftueshmëria e të dhënave dhe informacionit në lidhje me biodiversitetin, niveli i ulët i kërkimit shkencor, dhe mungesa e monitorimit të vazhdueshëm dhe sistematik janë të probleme të rëndësishme për planifikimin dhe menaxhimin. Sidoqoftë, zona ka rëndësi ndërkombëtare me kërcënime të konsiderueshme. Pothuajse gjysma e llojeve të shpendëve të ujit në Deltën e Bunës janë përfshirë në listën e llojeve të rrezikuara në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëtar.

Ligatinat e bashkuara të Bunës dhe Liqenit të Shkodrës mbështesin 900–1.000 lloje bimësh dhe popullata të mëdha (rreth 25.000) shpendësh uji shtegtarë.

Mbi 76% e llojeve të shpendëve në Deltën e Bunës janë shtegtarë; zona është një pjesë e rëndësishme e rrugëve ajrore të shpendëve shtegtarë evropianë që kalojnë mbi Ballkan, duke theksuar rëndësinë e saj ndërkombëtare.

Gryka e lumit Buna përbën një shembull të rrallë të një delte natyrore në bregdetin lindor të Adriatikut. Lumenjtë e bashkuar Buna dhe Drini kanë rëndësi shumë të madhe si rrugë shtegtimi për peshqit, duke lidhur liqenin e Shkodrës me Detin Adriatik.

Trysnitë mbi llojet e egra të zonës përfshijnë peshkimin jo të qëndrueshëm dhe të paligjshëm që përdor metoda shkatërruese peshkimi dhe gjuetie. Prerja e pemëve dhe zgjerimi i kullotave po kontribuojnë në shpyllëzimin e vazhdueshëm. Ka ndodhur një përkeqësim i madh i pyllit me Lisa të Shkodrës. Sa i takon biodiversitetit bujqësor, si pasojë e futjes së llojeve dhe varieteteve të reja të kafshëve dhe bimëve (gjedhë, drithëra, perime, etj.) kultivarët lokale janë në rënie.

Habitatat gjysmë natyrore si dunat bregdetare dhe ligatinat po përjetojnë përkatësisht një erozion dhe fragmentim të konsiderueshëm. Ligatinat në anën shqiptare kërcënohen nga mbi pompimi i ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore për ujitje.

Në përgjithësi, përveç trysnive ekziston një nivel të ulët të ndërgjegjësimit të publikut në lidhje me çështjet mjedisore.

Turizmi

Ndikimi i përgjithshëm ekonomik i turizmit në zonë, ndonëse po tregon rritje, është ende i pamjaftueshëm, kryesisht si pasojë e nën shfrytëzimit të kapacitetit të disponueshëm akomodues, mbizotërimit të llojit rezidencial të turizmit, dhe përqendrimit të veprimtarive të turizmit gjatë dy muajve të verës- korrik dhe gusht.

Veprimtaritë e turizmit, të ndërthurura me zhvillime të tjera bregdetare, kanë pasur një numër ndikimesh negative në zonën e Planit duke përfshirë:

- Humbjen, degradimin dhe fragmentimin e habitateve natyrore, veçanërisht të habitateve bregdetare dhe ligatinore.
- Degradimin e peizazhit nëpërmjet ndërtimit të mjediseve të reja turistike dhe infrastrukturës.
- Ndotjen e ujërave detare dhe të ëmbla si pasojë e shkarkimit të ujërave të ndotura dhe të pa trajtuara.
- Shqetësimi i zonave të jetës së egër veçanërisht në pikun e stinës së verës.

Infrastruktura

Infrastruktura ekzistuese e pamjaftueshme në të gjithë zonën e Planit nuk është përshtatur plotësisht me shndërrimin e shpejtë hapësinor. Në veçanti në Shqipëri, kjo ka sjellë mungesën e plotë apo të pjesshme të shërbimeve të infrastrukturës.

Rrugët janë në gjendje jo të mirë, për shkak të mirëmbajtjes së pamjaftueshme. Bllokimet e rënda të trafikut janë të shpeshta gjatë muajve të verës, veçanërisht në Malin e Zi.

Sistemet e ujit të pijshëm përbëjnë shqetësim të veçantë. Burimet e ujit të pijshëm janë të pamjaftueshme për të plotësuar kërkesat e pikut në verë dhe rrezikohen të ndoten.

Menaxhimi i ujërave të ndotura nuk është i qëndrueshëm duke sjellë ndotjen e ujit dhe kështu edhe degradimin e ekosistemeve si edhe ndotjen nga mikroorganizma të dëmshme nga mjediset tokësore dhe detare, me rreziqe ndaj shëndetit të njeriut.

Sistemet e mbledhjes dhe largimit/asgjësimit të mbetjeve të ngurta përbëjnë një shqetësim të ngjashëm në të gjithë zonën e Planit. Cilësia ekologjike dhe estetike e brigjeve të lumit dhe trupave ujorë është përkeqësuar shumë, kryesisht si pasojë e hedhjes së plehrave të ngurta gjatë gjithë sistemeve të lumenjve. Shërbimet lokale të mbledhjes janë jo konsistente, duke variuar nga të organizuara mirë, në Malin e Zi në jo ekzistente në Shqipëri ku hedhja e paligjshme përgjatë rrugëve, kanaleve kulluese dhe ujitëse është e zakonshme. Vend-depozitimet (landfillet) ekzistuese janë të pamjaftueshme për të përmbushur me efikasitet kërkesën dhe një burim i rëndësishëm i ndotjes. Nuk ka sistem për menaxhimin e sigurt të mbetjeve të rrezikshme jo vetëm në zonën e Planit por në mbarë Shqipërinë.

Mungesa e investimeve në dekadat e fundit është rënduar nga zhvillimi i pakontrolluar, një prirje që ka gjasa të vazhdojë. Në Malin e Zi, aderimi në BE dhe përputhshmëria me *acquis communautaire* mund të nxisë përmirësimin e sistemeve të mbetjeve të ngurta dhe ujërave të ndotura; Shqipëria është shumë prapa Malit të Zi sa i takon procesit të hyrjes në BE; sidoqoftë, është në të njëjtën rrugë që mund të konsiderohet si një nxitës i mirë investimesh në Shqipëri.

Konteksti institucional dhe ligjor

Si në Shqipëri edhe në Malin e Zi, politikat, ligjet dhe institucionet po ndryshojnë me shpejtësi, pjesërisht si përgjigje ndaj kërkesave të procesit të hyrjes në BE.

Për proceset e vendimmarrjes që lidhen me menaxhimin e basenit të Drinit, duke përfshirë edhe zonën e Bunës, janë krijuar mekanizma bashkërendimi të nivelit të lartë; Veprimi i Bashkërenduar për Drinin (CORDA) mbështetet në

Memorandumin e Mirëkuptimit të nënshkruar nga vendet në të cilat kalon lumi Drin – duke përfshirë Shqipërinë dhe Malin e Zi- në nëntor 2011.

Pas zbatimit të suksesshëm të Projektit të Malit të Zi për Programin e Menaxhimit të Zonës Bregdetare (CAMP), menaxhimi i zonës bregdetare po merr rëndësinë e tij politike, i ndjekur nga organizimi i kuadrit qeverisës për MIZB-in (miratimi i strategjisë së MIZB-it dhe ngritja e mekanizmit të bashkërendimit). Gjithashtu, zona bregdetare në të dyja vendet mbulohet nga marrëveshjet në kuadër të Drin Corda. Sidoqoftë, menaxhimi bregdetar në vetvete ka nevojë për më tepër fokus në Shqipëri- në përputhje me Protokollin MIZB- i mundshëm përmes strukturave të integruara.

Ekziston nevoja për përmirësimin e kapaciteteve në nivel kombëtar dhe lokal si edhe për fushata për rritjen e ndërgjegjësimit dhe nisma të tjera për të ndryshuar zbatimin e ligjit aktual dhe normën e zbatimit të qasjeve të integruara në menaxhimin e ekosistemeve bregdetare dhe detare.

Qeveritë vendore përbëjnë pjesën kryesore të kuadrit institucional ku në veçanti nevojitet fuqizimi i tyre.

3. Formulimi i Vizionit

Përtej fazës së Analizës më sipër është e nevojshme të formulohet një vizion i gjerësisht pranuar për zonën e Planit, i cili do të formësojë masat e hollësishme vijuese.

Vizioni i mëposhtëm mbështetet në takimet e organizuara me grupet e interesit gjatë fazës së hershme të Planit, konsultimet me ekspertët kryesorë kombëtarë, dhe tek Analiza e Grupeve të Interesit e përshkruar në Shtojcën 2.

Sfida e ardhshme për suksesin e Planit qëndron tek integrimi real dhe kuptimplotë d.m.th. në krijimin e sinergjive dhe lidhjeve kritike ndërmjet grupeve të interesit, dhe në kapërcimin e pengesave administrative për trajtimin e çështjeve globale, rajonale dhe lokale, me synimin përfundimtar të arritjes së një rruge zhvillimi të qëndrueshëm.

Analiza dhe konsultimet e zhvilluara deri tani kanë ndihmuar në identifikimin e qëllimeve kryesore rreth të cilave do të formulohet vizioni. Këto qëllime janë renditur më poshtë dhe së bashku përfaqësojnë vizionin e mundshëm për një zonë ndërkufitare të qëndrueshme të Bunës në 15 vitet e ardhshme.

Janë zhvilluar burimet dhe procedurat e nevojshme në mënyrë që:

- **Menaxhimi i burimeve natyrore në nivel kombëtar të jetë më i integruar.**
- **Zona e Bunës e Malit të Zi dhe Shqipërisë të jetë një shembull i bashkëpunimit të suksesshëm ndërkufitar në Evropën Juglindore duke përfshirë:**
 - **Bashkërendimin efektiv institucional në formën e mekanizmit për planifikimin dhe menaxhimin e integruar të zonës së Bunës, me kapacitete të mjaftueshme mbështetëse. Çështjet që janë pjesë e mandatit të tij mund të përshijnë të gjitha ujërat e mëposhtme apo një pjesë të tyre si edhe: menaxhimin e burimeve natyrore, mbrojtjen**

e biodiversitetit, reduktimin e ndotjes dhe përshtatjen me ndryshimin e klimës.

- **Rritjen e bashkëpunimit ndërkufitar në fushën e ekonomisë me synim krijimin e programeve të bashkërenduara të zhvillimit duke shfrytëzuar burimet e përbashkëta.**

Këto më pas do të ndihmojnë që:

- **Infrastruktura të ketë standardin më të lartë të përshtatshëm për të siguruar furnizim me ujë dhe menaxhim të qëndrueshëm të mbetjeve për përmirësimin e ekosistemeve, shëndetit dhe cilësisë së ujit.**
- **Të krijohen kushtet për mbrojtjen dhe rritjen e vlerës së lartë të biodiversitetit të zonës.**
- **Avantazhet konkurruese të vlerave kulturore dhe natyrore të rajonit të shfrytëzohen në mënyrë të qëndrueshme për të mbështetur një turizëm me vlera të larta.**
- **Në përgjithësi, mirëqenia ekonomike dhe sociale e komunitetit të zonës të jetë në përputhje me normat e BE-së.**
- **Zhvillimi të jetë i mirë planifikuar dhe i rregulluar, duke respektuar vlerat natyrore dhe të peizazhit.**
- **Zona të përshtatet me ndikimet e ndryshimeve klimatike.**

Masat e përshkruara në vijim në Plan janë projektuar për të ndihmuar në përcaktimin e një kursi për përmbushjen e vizionit të formuluar më sipër.

4. Hartimi i Planit- identifikimi i nxitësve, trysnive dhe ndikimeve

Për strukturimin e analizës së ndërveprimit kompleks ndërmjet fushave tematike dhe reagimit që lidhet drejtpërdrejt me Planin e Veprimit, u përdor kuadri "NPGJNR". NPGJNR-ja ofron një vështrim sistemik në mënyrën në të cilën për shembull: **Nxitësit** socialë dhe ekonomikë si joshja/atraktiviteti e zonës bregdetare në sinergji me kapacitetet e dobëta institucionale çojnë në krijimin e **Trysnive** mbi mjedisin si p.sh. urbanizimi i paplanifikuar. **Gjendja** përcakton përmasat e këtij problemi: p.sh. sa gjerësisht është përhapur, zhvillimin e pa shërbyer, numrin e ndërtimeve pa

leje. Kjo më pas sjell **Ndikimet** tek ekosistemet, peizazhet dhe ndotjen e ujit, ose koston e shërbimeve të infrastrukturës. **Reagimi** (apo mungesa e tij) mund të përfshijë për shembull, masat për përmirësimin e rregulloreve apo instrumenteve financiare për të frenuar këtë lloj zhvillimi. Pastaj reagimet ndikojnë tek forcat nxitëse, trysnitë apo tek Gjendja dhe ndikimet. Në realitet, marrëdhëniet nuk janë qaq lineare dhe nxitësit, trysnitë, Gjendja dhe ndikimet ndërlidhen në mënyra komplekse dhe të mbivendosura.




Figura 5: Cikli NPGJNR

Panorama e gjerë që rezulton nga kjo analizë bazë për Zonën Ndërkufitare të Zonës së Bunës së paraqitet më poshtë në mënyrë të përmbledhur.

Nxitësit

Nxitësit kryesorë të kushteve në zonë mund të grupohen në 12 kategori të gjera. Të gjithë nxitësit hasen si në Shqipëri ashtu edhe në Malin e zi, sidoqoftë mund të ketë ndryshime sa i takon intensitetit dhe shkallës të secilit nxitës në të dyja vendet:

1. Joshja/atraktiviteti i bregdetit / Zhvillimi në rritje

Kapitali natyror, në veçanti joshja/ atraktiviteti i tij ka qenë një nga nxitësit kryesor të zhvillimit. Zonat

bregdetare të Shqipërisë dhe Malit të Zi i janë nënshtruar trysnisë intensive të tregut për zhvillim rezidencial dhe turistik në dy dekadat e fundit. Zhvillimi ka ndodhur me një ritëm që ia kalon kapacitetit të administratave për të rregulluar ashtu si duhet apo ofruar shërbimet themelore.

2. Paqëndrueshmëria dhe ndryshimet e klimës

Sipas të gjitha modeleve, zona është ndërmjet atyre zonave që janë mjaft të ekspozuara ndaj paqëndrueshmërisë dhe ndryshimit të klimës. Rritja e nivelit të detit mund të ketë efekte të konsiderueshme veçanërisht në lagunat dhe gotullat bregdetare. Më rritjen e kripësisë, mund të ketë ndryshime në natyrë dhe ekosisteme. Incidentet e reshjeve të skajshme ka të ngjarë të shtohen.

Lumi Buna dhe pellgjet ujëmbledhëse të rrjedhës së sipërme të Drinit të Poshtëm dhe Liqenit të Shkodrës kërcënohen nga një rrezik i lartë përmbytjeje; rreziku mund të rritet në varësi të nivelit në të cilin ndryshimi i klimës ndikon zonën.

3. Dobësitë ekonomike strukturore dhe tranzicioni i tregut

Zona karakterizohet nga disa prej të ardhurave më të ulëta në vendet evropiane². Kjo funksionon si shkurajim për përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore. Gjithashtu, ekonomitë e zonës kanë përjetuar tranzicionin nga socializmi tek tregjet e lira. Investimet në infrastrukturë si rrugë, rrjete kanalizimesh dhe trajtimi i ujërave të ndotura, mbrojtja nga përmbytjet, menaxhimi i ujit dhe mbetjeve kanë rënë ndjeshëm që nga epoka e socializmit.

4. Çështjet strukturore në sektorin e bujqësisë

Në Shqipëri sektori i bujqësisë karakterizohet nga zhvillimi i pamjaftueshëm, me çështje themelore strukturore nga fragmentimi i tokës tek problemet e pronësisë dhe tranzicioni në një ekonomi tregu, dhe ku sistemi i ujitjes është në gjendje të keqe dhe ka mungesë investimesh. Në Malin e Zi sektori karakterizohet nga braktisja e fushave bujqësore dhe ndryshimi i kategorisë së përdorimit të tokës, nga bujqësi në zhvillim/ ndërtim.

5. Ndryshimet demografike

Pavarësisht nga urbanizimi i shpejtë në zonë prirja mbizotëruese demografike është migrimi në zonat urbane apo jashtë shtetit për mundësi më të mira ekonomike. Nëse nuk do të ketë një ndryshim të ndjeshëm në mundësitë ekonomike dhe arsimore, këto prirje nuk kanë gjasa të ndryshojnë.

6. Planifikimi zhvillimor dhe prioritizimi

Planifikimi zhvillimor nuk merr parasysh ndërlidhjet që shfaqen në sistemet natyrore që rezultojnë në zgjedhje konfliktuale. Kërkesat intensive për zhvillimin urban dhe turistik nuk janë harmonizuar me nevojën për ruajtjen e vlerave natyrore dhe të peizazhit të zonës duke minuar kështu potencialin e turizmit me vlerë të lartë që do të mundësonte qëndrueshmërinë e rritjes në zonë.

7. Nxitësit në rrjedhën e sipërme të lumit

Urbanizimi dhe menaxhimi i përdorimit të tokës në rrjedhën e sipërme të lumit kanë rezultuar në një sërë trysnesh. Prodhimi i energjisë elektrike nga hidrocentralet; funksionimi i infrastrukturës së hidrocentraleve në rrjedhën e sipërme po fokusohet në maksimizimin e prodhimit të energjisë elektrike. Rregullat dhe praktikatat e funksionimit të digës nuk marrin parasysh rrezikun e incidenteve të përmbytjeve në rrjedhën e poshtme në rast të kushteve të skajshme meteorologjike.

8. Kuadri politik dhe ligjor

Kuadri politik është i pamjaftueshëm për të adresuar siç duhet çështjet e qëndrueshmërisë. Në veçanti sa i takon urbanizimit, kuadri i dobët i politikave lidhet kryesisht me mungesën e instrumenteve financiare (taksat) dhe ato të politikave për tokën që do të shkurajonin mbi-urbanizimin, shndërrimin e tokës bujqësore në truall ndërtimi dhe kështu me radhë. Gjithashtu, titujt e paqartë të pronësisë në Shqipëri i pamundësojnë më tej vendimet e politikave drejt urbanizimit të rregulluar.

9. Kapaciteti i dobët institucional dhe teknik

Zbatimi i legjislacionit pengohet nga kompetencat e mbivendosura apo madje edhe mungesa e delegimit të qartë dhe fragmentimit të përgjegjësive ndërmjet institucioneve dhe agjencive të ndryshme përgjegjëse për menaxhimin e njësive të ndryshme hapësinore (p.sh. bashkitë, basenet lumore, zonat e mbrojtura). Komunikimi dhe bashkërendimi joefektiv ndërmjet Ministrive dhe

² PBB-ja për frymë (2011) në zonë është e ulët, në krahasim me mesataren e BE-së (€25,200; Eurostat); konkretisht në Malin e Zi ishte €5,211 dhe në qarkun e Shkodrës u llogarit €2,175 në vitin 2011, ndër më të ulët në Shqipëri.

organizmave të ndryshme përbën gjithashtu një problem madhor.

Kapaciteti i administratave, veçanërisht në nivel lokal, sa u takon burimeve njerëzore, financiare dhe teknike- për monitorimin e paralajmërimit të përmbytjeve, hidro-meteorologjik , cilësisë së ujit, dhe atij biologjik është i ulët.

Gjithashtu, planifikimi territorial nuk mbështetet siç duhet në studimet shkencore, si për shkak të mungesës së të dhënave dhe/ose mungesës së të dhënave në formën e duhur, edhe nga paaftësia e planifikuesve për të interpretuar të dhënat e disponueshme dhe për t'i përfshirë ato në procesin e planifikimit.

10. Infrastruktura e vjetruara apo të pamjaftueshme

Infrastruktura bazë si rrjeti rrugor, sistemet e kanalizimeve, largimi i mbetjeve janë të vjetruara, jo të mirëmbajtura apo mungojnë tërësisht. Mirëmbajtja e kanaleve kulluese dhe strukturave të parandalimit të përmbytjeve në Shqipëri dhe argjinaturat në Malin e Zi janë të dobëta. Rrugët janë në gjendje të keqe, nuk mirëmbahen siç duhet.

11. Aderimi në BE

Procesi i aderimit dhe anëtarësimi i mundshëm në BE nxisin ndryshime të konsiderueshme teksa vendet përpiqen të jenë në pajtueshmëri me legjislacionin mjedisor të BE-së dhe të sigurojnë akses tek mbështetja për mundësitë e investimeve të BE-së në infrastrukturë dhe ekonomi. Shqipëria ka marrë statusin e “Vendit Kandidat” dhe Mali i Zi është në procesin e negociatave për hyrjen në BE.

12. Mungesa e ndërgjegjësimit

Banorëve të rajonit u mungon edukimi dhe ndërgjegjësimi i duhur për të mbështetur zhvillimin e shpejtë drejt qëndrueshmërisë.

13. Karakteri ndërkufitar i zonës

Zona e Bunës është një sistem i vetëm natyror që shtrihet në dy vende. Bashkërendimi ndërkufitar

për momentin po synon t'i adresojë problemet e lidhura me përmbytjet në mënyrë *ad-hoc*.

Trysni të dhe Gjendja Aktuale

Këta nxitës ndërthuren për të krijuar trysni të mëposhtme:

1. Zhvillimi i paqëndrueshëm territorial/hapësinor duke përfshirë:

- **Zhvillimin urban të parregulluar në mënyrë të mjaftueshme:** zona karakterizohet nga zhvillimi i shpejtë gjatë kohëve të fundit, veçanërisht në rripin e ngushtë 5 km larg bregut, dhe në përgjithësi ka karakter linear përgjatë vijës bregdetare dhe rrugëve kryesore. Bumi i ndërtimit që filloi në vitet 1990 u pasua nga rritja e zhvillimit informal, të paligjshëm (ndërtimeve pa leje). Mungon kontrolli i duhur dhe ka mekanizma të pamjaftueshëm për sanksionimin e ndërtimeve pa leje. Gjithashtu, zhvillimi karakterizohet nga mungesa e respektit për vlerat natyrore dhe të peizazhit.
- **Mbi-alokimi i truallit për ndërtime në Malin e Zi:** në Malin e Zi ekziston një “mbi-ofertë” e tokës së caktuar për ndërtime; planet urbane alokojnë tokë të mjaftueshme për të strehuar një popullsi disa herë më të madhe se popullsia ekzistuese. Shpesh, kjo situatë rezulton në një zhvillim të shpërndarë pa kriter, i cili nuk pasohet nga shërbimet e duhura komunale (për shkak të kostove shumë të larta infrastrukture).
- **Mungesa e planeve territoriale në Shqipëri:** mungesa e planifikimit të zhvillimit dhe ndërtimit që sjell për pasojë “anarkinë” në ndërtim dhe urbanizim ka ndodhur lirshëm dhe me shumë pak kufizime.

2. Menaxhimi i paqëndrueshëm i mbetjeve të ngurta

Sistemet e mbledhjes dhe largimit/asgjësimit të mbetjeve të ngurta janë të pamjaftueshme, duke variuar nga relativisht të organizuara në Malin e Zi te problematike në Shqipëri. Në Malin e Zi, mbetjet nga qendrat urbane asgjësohen në një landfill

sanitar. Në Shqipëri hedhja e paligjshme e mbetjeve të ngurta është e zakonshme përgjatë rrugëve, kanaleve kulluese dhe ujitëse; kjo mund të ketë ndikim mbi lumin, cilësinë e ujërave nëntokësore dhe ujit të detit. Menaxhimi i paqëndrueshëm i mbetjeve të ngurta në zonat e rrjedhës së sipërme kanë gjithashtu ndikim të madh në zonën e Bunës.

3. Menaxhimi i paqëndrueshëm i ujërave të ndotura

Ngarkesa të mëdha N dhe P vijnë nga ujërat e ndotura- nga bashkitë në zonën e Bunës dhe nga qyteti i Shkodrës. Gjithashtu, burim i mundshëm i ushqyesve në ujërat nëntokësore është infiltrimi nga rrjedhja nga sistemet septike.

4. Praktikrat e paqëndrueshme bujqësore

Është treguar se ka përdorim të paqëndrueshëm të plehrave organike dhe pesticideve. Gjithashtu, ekziston një përdorim i paqëndrueshëm dhe asgjësim i materialeve që përdoren në bujqësi, si plastmasa në sera. Ka të dhëna për mbi-pompim të ujit për ujitje. Ujërat e liqeneve dhe ligatinave të vogla përdoren për ujitje në anën shqiptare.

5. Blegtoria

Ka të dhëna që një burim kryesor i sasisë totale të N në pellgun ujëmbajtës të Bunës është kullotja e lirë/blegtoria informale, mbizotëruese në pjesën shqiptare.

6. Regjimi i rrjedhës së ujit në Drin

Hidrologjia e Bunës ndikohet nga regjimi i rrjedhës së ujit të Drinit që rregullohet nga kaskada e digave për prodhimin e hidrocentraleve që funksionojnë për të siguruar prodhimin maksimal të energjisë.

7. Mbi shfrytëzimi i burimeve të ujërave nëntokësore

Nuk ka një monitorim sistematik të niveleve të ujërave nëntokësore apo nxjerrjeve në zonën e Planit. Sidoqoftë, ka ta ngjarë që disa nga akuiferet bregdetare (aluviale dhe karstike) po mbi shfrytëzohen, siç vërtetohet nga prania e ujit me kripë tek burimet që shkarkohen nga akuiferet

karstike (shembulli i burimit të Gacit) dhe gjithashtu edhe në ujërat nëntokësore që nxirren dhe shfrytëzohen për ujitje në Ulqin dhe Tivar.

Gjithashtu, projeksionet e nevojave të ardhshme për ujë për ujitje dhe ujë të pijshëm tregojnë që burimet e ujërave nëntokësore do të shfrytëzohen gjithnjë e më shumë në vitet e ardhshme.

Gjithashtu, ky zhvillim rrit nevojën për ujë gjatë muajve të verës që ushtrojnë trysni mbi burimet e ujit të pijshëm (kryesisht ujëra nëntokësore) që janë të pamjaftueshme për të plotësuar kërkesat e “pikut”. Në Shqipëri uji i pijshëm përdoret për ujitje në disa raste.

8. Prurja e lartë e sedimenteve

Rritja e ngarkesave të sedimenteve po hyjnë në sistemin e Bunës përmes degëve të Drinit në rrjedhën e poshtme të digave si pasojë e erozionit që shkaktohet nga nxjerrja e zhavorrit dhe humbja e mbulimit me bimësi.

9. Mirëmbajtja e keqe e infrastrukturës së përmytjeve/ kullimit

Kanalet natyrore dytësore të Lumit Buna që ekzistonin në të shkuarën në zonën e deltës janë bllokuar dhe si rezultat prurja maksimale e tejkalon kapacitetin e kanalit kryesor (ekzistues). Gjithashtu, kanalet kulluese dhe konstruksionet për parandalimin e përmytjeve në anën shqiptare dhe argjinaturat në anën malazeze janë mirëmbajtur dobët.

10. Menaxhimi i paqëndrueshëm i pyjeve

Prerja e paligjshme dhe abuzive e pemëve, mbledhja e zgjeruar e druve të zjarrit, kullotja e pakontrolluar e shoqëruar nga menaxhimi i dobët i pyjeve në Shqipëri, ka sjellë përkeqësimin e pyjeve. Ndryshimet në përdorimin e tokës kanë ndikim të drejtpërdrejtë edhe tek pyjet; pyjet natyrore gjatë bregut të detit kërcënohen apo janë dëmtuar tashmë nga ndërtimet.

11. Menaxhimi i paqëndrueshëm i peshkimit

Mungesa e kapaciteteve ligj zbatuese dhe rregulloret e pamjaftueshme kanë sjellë peshkimin e paligjshëm dhe përdorimin e praktikave të peshkimit që janë shkatërruese për ekosistemet; gjithashtu, këto praktika pengojnë rrugët e shtegimit të peshqve në Lumin Buna.

12. Gjuetia e paqëndrueshme dhe e paligjshme

Gjuetia e paqëndrueshme dhe e paligjshme është një problem; gjuetia e paligjshme ndodh kryesisht për shkak të kapacitetit të ulët të zbatimit të ligjit. Ka shkelje në lidhje me:

- Statusin e mbrojtjes së disa zonave d.m.th. zonat ku ndalohet gjuetia, si kriporja e Ulqinit e cila është një zonë me rëndësi shumë të madhe për llojet shtegtare;
- Llojet gjuetia e të cilave lejohet p.sh. gjuetia e shpendëve të rrallë dhe të rrezikuar si e laraska e detit (*Haematopus ostralegus*), karabullaku i vogël (*micarbo pygmeus*), gjatë sezonit të shumimit, qyrylyku këmbëqiri (*Tringa tetanus*), sqep biza (*Recurvirostra avocetta*), etj.;
- Periudha e ndalimit të gjuetisë³.

Statistikat kryesore – “Gjendja”

Në përgjithësi, mungesa e kapacitetit monitorues ka sjellë mangësi në nivelin e të dhënave dhe informacionit për pothuajse të gjitha fushat e politikave. Sidoqoftë, treguesit e mëposhtëm ofrojnë një përshkrim të gjendjes aktuale të zonës:

- Zonat e rëndësishme të degraduara me zhvillim të paplanifikuar (në veçanti në Shqipëri), informal (të paligjshëm), me vlera të ulëta estetike ndërtimi. Në Shqipëri, të paktën 60% e të gjitha ndërtesave janë të paligjshme (80% në Velipojë). Në Malin e Zi 12.7% e të gjitha ndërtesave të paligjshme në vend ndodhen në Ulqin.

- Urbanizim i shpërndarë, mbi tokat e punueshme dhe ato me vlera të mëdha natyrore.
- 7.5% e tokës 1 km nga vija bregdetare e zonës bregdetare e Ulqinit dhe 10% e zonës bregdetare shqiptare është zënë nga ndërtimet.
- 12% pjesës ballore të vijës bregdetare është e urbanizuar në Malin.
- Infrastrukturat komunale janë të pamjaftueshme: sistemet e shpërndarjes së ujit të pijshëm janë të pamjaftueshme për të plotësuar nevojat e pikut në verë dhe janë në rrezik ndotjeje; infrastruktura sanitare është problematike; infrastruktura e mbetjeve të ngurta është e pamjaftueshme. Transporti është i pamjaftueshëm dhe sistemi rrugor ka cilësi të dobët dhe nuk mirëmbahet.
- Regjimi i dinamikës bregdetare ka ndryshuar. Ka erozion në disa pjesë të Deltës së Bunës dhe ka depozitime të rërës në pjesë të tjera; vija bregdetare është tërhequr në disa pjesë të bregdetit në grykën e Bunës me rreth 500 m që nga 1936 dhe rreth 50 m në 20 vitet e fundit.
- Ka gjithashtu erozion të tokës ngjitur me lumin.
- Regjimi natyror i rrjedhës së ujit të Bunës është prishur.
- Regjimi natyror i rrjedhës së sedimenteve është prishur. Ka një reduktim 13 herë në ngarkesat e sedimenteve; në të njëjtën kohë ka një prurje periodikisht të lartë të sedimenteve përmes degëve të rrjedhës së poshtme të Drinit, kaskadës së digave dhe rrjedhës së sipërme të Bunës.
- Eutrofikimi është i pranishëm në ujërat tranzitore dhe bregdetare.
- Statusi biologjik i trupave ujorë sipërfaqësorë – në përputhje me DKU- në të gjitha stacionet ku të dhënat kanë qenë të disponueshme është vlerësuar si i dobët (sipas analizës së mostrave të marra gjatë tri periudhave të ndryshme duke përdorur tregues biologjikë).
- Statusi kimik i lumit Buna- në përputhje me DKU- në – është vlerësuar si “mesatar”. Ka ndotje nga metalet e rënda (sipas analizës së mostrave të

³ Një hap i rëndësishëm i ndërmarrë nga Shqipëria ishte ndalimi i plotë me ligj i gjuetisë që hyri në ligj gjatë periudhës mars 2014- mars 2016.

marra gjatë tri periudhave të ndryshme- seritë e të dhënave nuk janë të mjaftueshme për të përcaktuar prirjet); elemente të ndryshme ishin mbi kufijtë e parashikuar nga legjislacioni në stacione të ndryshme të marrjes së mostrave⁴.

- Cilësia e Lumit Buna në drejtim të përqendrimeve të amoniakut dhe BOD5 përkeqësohet nga burimi tek grykëderdhja e tij.
- Ka rritje të përqendrimeve të merkurit në Liqenin Shasko në malin e Zi. Përqendrimi i merkurit është mbi kufijtë e lejuar edhe në lagunën e Vilunit në Shqipëri.
- Cilësia ekologjike- në përputhje me DKU-në e ujërave të zonës bregdetare është klasifikuar si “e keqe”.
- Ka një rënie të mundshme në nivelet e ujërave nëntokësore dhe përkeqësim të cilësisë së tyre. Ka të dhëna të kufizuara në lidhje me ndotjen e ujërave nëntokësore por hetimet e fundit në terren tregojnë që në disa zona nivelet e nitratit në ujërat nëntokësore i tejkalojnë shumë ato të Lumit Buna.
- Ka të dhëna për ndërhyrjen e ujërave me kripë teksa përqendrime të larta kloruri janë zbuluar në disa burime gjatë periudhës së verës në Malin e Zi. Të dhënat përkatëse janë të kufizuara për shkak të mungesës së monitorimit të rregullt dhe të bashkërenduar në nivele kombëtare dhe ndërkufitare.
- Cilësia e peizazhit të zonës ka degraduar. Cilësia ekologjike dhe estetike e brigjeve të lumit është përkeqësuar shumë, kryesisht si pasojë e hedhjes së plehrave përgjatë lumit dhe brenda tij.
- Ka degradim (fragmentim) të habitateve bregdetare, kryesisht në dunat e Velika Plaža dhe në pjesën e Rrjollit. Ka pasur një përkeqësim të madh (në vitin 1994) në Pyllin me Lisa të

Shkodrës (*Quercus robur scutariensis*) në Štoj në fund të Velika Plaža.

- Zona më të vogla ligatinore (në Shqipëri) po tkurren.
- Ka humbje të llojeve të rralla në brezin e bimësisë halofite.
- Zvogëlimi i popullsisë së shpendëve është përlllogaritur në gamën 10-20% - sidoqoftë nuk po zbatohet ndonjë program monitorimi në terren për të verifikuar këto shifra. Përshtatshmëria e deltës së Bunës për shumimin e zogjve shtegtarë është dëmtuar. Ndikimet e sakta nuk mund të vlerësohen meqë të dhënat janë të kufizuara si pasojë e mungesës së monitorimit të rregullt dhe të bashkërenduar në nivele kombëtare dhe ndërkufitare.
- Është penguar shtegtimi i peshqve në lumin Buna.
- Ka një rënie të sasisë së peshkut të kapur në 25 vitet e fundit në nivelin f 20-80% në varësi të llojeve (sipas shoqatës shqiptare të peshkimit).
- Disa varietete dhe kultivarë (bujqësorë) lokalë janë në rënie dhe drejt zhdukjes.
- Janë rritur rreziqet e përmytjeve. Frekuenca dhe intensiteti i përmytjeve është rritur- dy incidente përmytjesh në vitin 2010 ishin më të rëndat të regjistruara në 80 vitet e fundit. Ka pasur dëme të mëdha të shtëpive dhe tokës bujqësore.
- Progresi në hartimin e legjislacionit të ri në lidhje me menaxhimin e burimeve natyrore, në përputhje kryesisht me *acquis communautaire e BE-së*, është i konsiderueshëm. Sidoqoftë, në disa raste madje edhe ligje të reja kanë mungesa thelbësore si përkufizime- në përputhje me kërkesat e KE-së- të drejtat dhe detyrimet e sakta për personat fizikë dhe juridikë, vendosjen e standardeve për t’u arritur dhe kufijtë/pragjet që duhen respektuar dhe gjithashtu në këto ligje nuk parashikohen fazat procedurale. Shumë nga ligjet e reja horizontale janë ligje kuadër. Këto kërkojnë një numër aktesh nënligjore dhe rregulloresh specifike dhe të hollësishme për të qenë të zbatueshme në praktikë. Janë

⁴ Merkur në të gjitha stacionet: Nikel në Dajç dhe degën e majtë të Bunës; kadmium në Fraskanjel dhe; Plumb në Dajç dhe Fraskanjel.

ndërmarrë disa hapa në drejtim të përgatitjes dhe miratimit të legjislacionit dytësor.

Ndikimet në Zonë

- Ka një degradim të përgjithshëm të peizazhit për shkak të zhvillimit të paplanifikuar, të shpërndarë dhe të shpejtë.
- Kostoja e lartë e ofrimit të infrastrukturës për shkak të zhvillimit të paplanifikuar, të shpërndarë dhe të shpejtë (shpesh përgjatë bregdetit dhe rrugëve kryesore) ka sjellë mungesën e pjesshme apo madje edhe të plotë të shërbimeve bazë të infrastrukturës.
- Menaxhimi aktual i mbetjeve të ngurta ka sjellë ndotjen e dukshme të brigjeve të lumit, kanaleve kulluese dhe ujitëse, plazheve dhe detit; ka rreziqe të mëdha edhe për ndotje. Menaxhimi i mbetjeve të lëngshme po çon drejt ndotjes së mjediseve tokësore/ujërave të ëmbla dhe atyre detare. Ka të dhëna për reduktimin e cilësisë së ujërave nëntokësore që përbëjnë rrezik për shëndetin e njeriut. Ka pasur rënie të cilësisë së ujërave për larje në disa zona.
- Kapitali dhe burimet natyrore në zonë janë përkeqësuar . Ekosistemet po degradojnë në deltën e Bunës si edhe në zonat e ligatinave duke sjellë për pasojë ndër të tjera edhe përkeqësimin e shërbimeve të ekosistemit. Ka ndodhur humbja e konsiderueshme e biodiversitetit- e përqendruar në zonën bregdetare; një numër i madh i llojeve të shpendëve ujorë në deltën e Bunës për shembull, po kërcënohen dhe janë përfshirë në listat e llojeve të rrezikuara në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëtar. Numri i llojeve të peshqve në lumë ka rënë. Ka erozion të tokës pranë lumit.
- Ka të dhëna për rënien e niveleve të ujërave nëntokësore dhe ndërhyrjes së ujërave detare në akuifere. Nëse kjo do të rezultojë e vërtetë ka rreziqe për bujqësinë që lidhen me përdorimin e ujërave nëntokësore për ujitje.
- Është cenuar ekonomia dhe po ashtu edhe potencialet për zhvillim. Ka lloje komerciale që nuk kultivohen më. Humbja e zonave natyrore

tërheqëse kërcënon potencialin për zhvillim të turizmit me vlera të larta dhe për pasojë dëmton potencialin ekonomik të zonës më të zgjeruar.

- Përkeqësimi i burimeve natyrore dhe ndërhyrja në proceset natyrore kanë sjellë një pasiguri të lartë në planifikimin e zhvillimit ekonomik vendor. Shembujt përfshijnë dinamikën e cenuar të vijës bregdetare që ka sjellë erozionin e pjesëve të zonës bregdetare dhe ka rrezikuar investimet në infrastrukturë dhe ato në turizëm. Gjithashtu, urbanizimi intensiv shpesh shtrihet mbi tokën e punueshme duke çuar në reduktimin e përgjithshëm të saj.
- Rreziqet në rritje të përmbytjeve për shkak të trysnive antropogjenike dhe potenciali në rritje për incidente të skajshme si pasojë e ndryshimeve klimatike kërcënojnë infrastrukturën, pronën dhe sigurinë e popullsisë.

5. Hartimi i Planit – Objektivat e Planit

Objektivat e Planit të përshkruara më poshtë përbëjnë fazën kryesore të integritimit në procesin e KMI-së. Ndërsa në fazat e mëparshme të procesit u bë identifikimi i një sërë çështjesh/problemesh gjithëpërfshirëse, moria e ndërveprimeve dhe mbivendosjeve ndërmjet tyre është komplekse, sikurse edhe gama e reagimeve dhe masave të politikave të mundshme.

Tetë objektivat e gjera të mëposhtme janë esenca e këtyre çështjeve të paraqitura në një seri të vetme prioritetesh që përmbushin më mirë vizionin e përgjithshëm të integruar të Planit, dhe nga të cilat mund të dalin objektiva dhe masa më specifike për t'iu përgjigjur çështjeve/problemeve të shumëfishta dhe të mbivendosura që u identifikuan. Objektivat e pranojnë që asnjë sektor apo politikë e vetme mund ta realizojë vetëm vizionin.

Objektivat e Planit

1. Përmirësimi i qeverisjes dhe bashkëpunimit ndërkufitar

Edhe zona e Bunës ndahet nga kufiri kombëtar, ekosistemi funksionon si një njësi e vetme. Siç tregon the analiza, shume nga problemet dhe shqetësimet mund të zgjidhen me mire nga bashkëpunimi ndërkufitar. Po ashtu, maksimizimi i mundësive të tilla si zhvillimi i turizmit mund të përfitojnë nga ky bashkëpunim. Me qellim përmirësimin e bashkëpunimit ndërkufitar dhe qeverisjes është parashikuar:

1.1 Krijimi i mekanizmave të duhura për të siguruar që çështjet/problemet përkatëse me rëndësi ndërkufitare (te tilla si turizmi bazuar në trashëgiminë natyrore dhe kulturore, përdorimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore, mbrojtja e mjedisit, adaptimi dhe zbutja e efekteve të ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rreziqeve) të merren në shqyrtim nga të dyja palët dhe të ndërmerren veprime të përbashkëta. Krijimi i këtij mekanizmi do të bazohet në marrëveshjet formale të bashkëpunimit ndërkufitar, te

negociuara dhe miratuara nga të dy vendet. Roli i mekanizmit të menaxhimit të koordinimit do të jete:

- Koordinimi i bashkëpunimit në zonën ndërkufitare në fushat e zhvillimit të qëndrueshëm, mbrojtjes së mjedisit dhe menaxhimit të ujërave.
- Lehtësimi i bashkëpunimit me nismat dhe projektet e tjera në zone.
- Identifikimi i nevojave të rëndësishme me qellim përmirësimin e gjendjes së përgjithshme të zonës ndërkufitare.
- Lehtësimi i konsultimeve midis autoriteteve përkatëse me qellim përcaktimin e programeve dhe projekteve ndërkufitare me synim zgjidhjen e problemeve të përbashkëta.
- Koordinimi i zbatimit të objektivave të planit.
- Sigurimi i asistencës teknike për aktoret lokale dhe kombëtare në përmirësimin e kapaciteteve të nevojshme për përmirësimin e bashkëpunimit ndërkufitar dhe arritjen e objektivave të planit.
- Mbështetja e hartimit dhe zbatimit të programeve dhe projekteve ndërkufitare nën të gjitha marrëveshjet dypalëshe të rëndësishme për zonën.
- Përmirësimi i vizibilitetit të zonës ndërkufitare dhe rritja e pjesëmarrjes së aktoreve të rëndësishëm në të gjitha organizatat dhe forumet e rëndësishme kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare.

1.2 Forcimi i bashkëpunimit nëpërmjet veprimeve të përbashkëta për menaxhimin e zonës ndërkufitare, veçanërisht nëpërmjet rritjes së përdorimit të fondeve të përshtatshme nga programet e financimit të BE (apo donatoreve të tjerë) te tilla si Instrumenti i Para-Hyrjes (IPA II) 2014-2020 me synim mbështetjen e zhvillimit ekonomik dhe reduktimin e pabarazive rajonale.

I.3 Rritja e Ndërgjegjësimit dhe përmirësimi i komunikimit mbi vlerat natyrore dhe kulturore të zonës së Planit, kërcënimet potenciale ndaj tyre dhe mundësitë e zhvillimit.

II. Mbështetja e ndryshimeve të politikave në nivel kombëtar

Edhe pse vëmendja e planit është përmirësimi i vlerave natyrore lokale (ndërkufitare) dhe mundësive të zhvillimit, shume prej çështjeve mbeten në përgjegjësinë e autoriteteve lokale e kombëtare, veçanërisht planifikimi hapësinor. Te dy vendet janë në procesin e kandidimit dhe hyrjes në BE dhe kanë mundësi për reforma politikash. Prandaj, objektivi specifik i planit përfshin:

II.1 Ndryshimin dhe/ose përmirësimin e rregulloreve kombëtare si dhe përmirësimin e zbatimit të tyre, duke i dhënë përparësi sektorëve të përdorimit dhe konsumit të ujit, zonave të mbrojtura, menaxhimit të bregdetit, peshkimit, gjuetisë, menaxhimit të mbetjeve, nxjerrjes së rërës dhe të tjera të ngjashme.

II.2 Përmirësimi i sistemit të planifikimit hapësinor

III. Zhvillimi dhe përdorimi sa më i mirë i njohurive bazë për menaxhimin e zonës ndërkufitare

Mungesa e të dhënave aktuale e krahasuese ka dale si një problem në identifikimin e opsioneve të qëndrueshme të menaxhimit, apo në monitorimin e ndikimeve të opsioneve politike. Vëmendja do të përqendrohet në objektivat specifike:

III.1 Krijimi i mekanizmave të vëzhgimit për të vlerësuar dhe përditësuar rregullisht informacionin në lidhje me mjedisin e krijuar nga njeriu dhe atë natyror. Mekanizmi duhet të jetë në formën e dy sistemeve të veçanta të monitorimit në nivel kombëtar që bashkëpunojnë me njëri tjetrin dhe përdorin parametra dhe teknike të njehsuara bashkërisht për grumbullimin dhe analizimin e informacionit. Duhet përcaktuar një nivel minimum të dhënash (për sa i përket karakteristikave dhe volumit) i miratuar nga të dy vendet në baze të standardeve ndërkombëtare (p.sh., DKU, Konventa

e Barcelonës, UNECE, EEA) dhe i bashkë ndarë reciprokisht.

- Mbështetje e integritetit të të dhënave shkencore në procesin e planifikimit
- Përmirësimi i kapaciteteve njerëzore e teknike të administratave lokale për të zbatuar planin.

IV. Përmirësimi i statusit (gjendjes) ekologjike dhe kimike të trupave ujore

Uji është përshkruar tashme si “gjaku” që ushqen natyrën dhe ekonominë, dhe cilësia e ujerave nëntokësore, lumenjve dhe përrenjve dhe detit është e një rëndësie të veçantë për të ardhmen e zonës. Objektivat specifike përfshijnë:

IV.1 Përmirësimi i cilësisë së ujërave të brendshme sipërfaqësore dhe atyre detare.

IV.2 Sigurimi i disponueshmërisë së ujit me cilësi të mirë për të gjitha përdorimet duke përfshirë edhe ekosistemet dhe përdorimin dhe konsumin e qëndrueshëm të ujit

IV.3 Ruajtja e cilësisë natyrore dhe kushteve hidrologjike të ligatinave të vogla.

IV.4 Përmirësimi i statusit të ujërave nëntokësore në drejtim të cilësisë dhe ruajtja e funksionit të akuifereve bregdetare për parandalimin apo ndryshimin/prapësimin e prirjeve salinizuese.

IV.5 Zvogëlimi i eutrofizimit dhe përmirësimi i cilësisë ekologjike të ujërave tranzitore dhe bregdetare.

V. Ruajtja dhe përmirësimi i vlerave të larta të biodiversitetit të zonës –

Vlera e lartë e biodiversitetit të zonës është e pamohueshme por ajo përballet me një sërë sfidash. Ruajtja dhe përmirësimi i saj është një përgjegjësi e madhe kombëtare dhe ndërkombëtare. Objektivat specifike përfshijnë:

V.1 Mbrojtjen dhe shtimin e vlerave natyrore të biodiversitetit të zonës ndërkufitare të Bunës

V.2 Përmirësimin e menaxhimit të zonave të mbrojtura.

V.3 Reduktimin dhe/ose eliminimin e ndikimeve të gjuetisë ndaj biodiversitetit.

V.4 Promovimi i peshkimit të qëndrueshëm.

VI. Ndhimë për rritjen e mirëqenies ekonomike dhe sociale e komunitetit të zonës

Zona ka nivelin më të ulët të mirëqenies ekonomike në Evropë. Problemet ekonomike shoqërohen nga infrastruktura e dobët dhe problemet mjedisore. Mundësitë për të përmirësuar si ekonominë dhe mirëqenien e popullsisë lokale drejtpërdrejt apo nëpërmjet përmirësimit të mjedisit duhet të jenë në qendër të procesit të planifikimit. Duke pasur parasysh vlerat natyrore të zonës, aktivitetet ekonomike që bazohen apo mbështesin ruajtjen e natyrës duhet të inkurajohen, objektivat specifike përfshijnë:

VI.1 Mbështetjen për bërjen e veprimtarive ekonomike të gjelbra/ të qëndrueshme.

VI.2 Promovimin e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm të zonës së Planit nëpërmjet turizmit që respekton vlerat e larta natyrore të zonës, vlerëson trashëgiminë e saj natyrore dhe kulturore duke maksimizuar vlerën e saj ekonomike për komunitetet vendase. Zbatimi i këtij objektivi mund të bëhet vetëm duke zbatuar objektivat dhe masat përkatëse për përmirësimin e cilësisë së ujit, shërbimeve sanitare, ruajtjen e biodiversitetit dhe menaxhimit të mbetjeve që ndikojnë në zhvillimin e turizmit. Megjithatë, paralelisht duhet të zhvillohet

edhe aftësia e zonës për të akomoduar vizitore në standarde të pranueshme.

VI.3 Përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve në zonë.

VII. Rritja e qëndrueshmërisë së zonës së Planit ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike dhe fatkeqësive natyrore

Vendndodhja, topografia dhe infrastruktura e vjetruar e zonës së Bunës e bëjnë zonën veçanërisht të cenueshme ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike dhe fatkeqësive natyrore si përmbytjet. Për këtë arsye, objektivat specifike përfshijnë:

VII.1 Uljen e rrezikut të përmbytjeve

VII.2 Mbrojtjen e vijës bregdetare që ndikohet nga ndryshimet klimatike dhe fatkeqësitë natyrore nga zhvillimi jo i qëndrueshëm.

VIII. Përmirësimi i cilësisë së peizazhit –

Zona ka një bukuri të madhe peizazhistike dhe kjo mund të jetë një burim për zhvillimin ekonomik në të ardhmen. Megjithatë, mungesa e planifikimit hapësinor efektiv apo zbatimi si duhet i tij dhe menaxhimi i dobët i mbetjeve minojnë potencialin e kësaj vlere thelbësore.

Integrimi i masave me nxitësit dhe fushat e ndryshme të politikave tregohet në diagramin e mëposhtëm (Figura 6).

NXITESIT		OBJEKTIVAT E PLANIT		POLITIKAT	
<p>Atraktiviteti i bregdetit</p> <p>Ndryshimet klimatike</p> <p>Dobësitë strukturale ekonomike dhe kalimi drejt ekonomisë së tregut</p> <p>Ndryshimet demografike</p> <p>Planifikimi dhe prioritizimi</p> <p>Faktorët e rrjedhjes së sipërme</p> <p>Kuadri ligjor dhe institucional</p> <p>Kapacitete të ulëta institucionale dhe teknike</p> <p>Infrastruktura të vjetra apo të papërshtatshme</p> <p>Hyrja në BE</p> <p>Mungesa e ndërgjegjësimit</p> <p>Aspekti ndërkuftar i zonës</p>	<p>PRESIONET</p> <p>GJENDJA</p>	<p>Përmirësimi i qeverisjes dhe bashkëpunimit ndërkuftar</p> <p>Mbështetja e ndryshimeve të politikave në nivel kombëtar</p> <p>Zhvillimi dhe përdorimi sa më i mirë i njohurive bazë për menaxhimin e zonës ndërkuftare</p> <p>Përmirësimi i statusit (9 gjendjes) ekologjike dhe kimike të trupave ujore</p> <p>Ruajtja dhe përmirësimi i vlerave të larta të biodiversitetit të zonës</p> <p>Ndihme për rritjen e mirëqenies ekonomike dhe sociale e komunitetit të zonës</p> <p>Rritja e qëndrueshmërisë së zonës së Planit ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike dhe fatkeqësive natyrore</p> <p>Përmirësimi i cilësisë së peizazhit</p>	<p>REAGIMI</p>	<p>Planifikimi hapësinor</p> <p>Cilësia e ujit</p> <p>Menaxhimi i ujerave nëntokësore</p> <p>Menaxhimi i përmbytjeve</p> <ul style="list-style-type: none"> • Parandalimi dhe zbutja e efekteve • Paralajmërimi <p>Menaxhimi i mbetjeve</p> <p>Ekonomia</p> <ul style="list-style-type: none"> • Turizmi • Peshkimi • Bujqësia <p>Biodiversiteti</p>	<p>NDERSEKTORIALE</p>

Figura 6: Integrimi i nxitësve me fushat e politikave dhe objektivat dhe masat përkatëse të përdorura për arritjen e tyre.

6. Realizimi i Vizionit

Kjo është faza kritike ku hartimi i politikave zhvendoset te lehtësimit i ndryshimit. Plani do të përdorë një ndërthurje të instrumenteve politike, proceseve dhe veprimeve të menaxhimit. Pikat e forta të MIZB-së dhe MIBU-së janë fleksibiliteti i tyre, përshtatshmëria me rrethanat lokale dhe funksionueshmëria në një gamë të gjerë sektorësh dhe çështjesh, dhe me një strukturë qeverisëse përfaqësuese. KMI-ja e çon një fazë më tej këtë fleksibilitet duke i integruar qasjet e MIZB-së dhe MIBU-së në një seri të vetme masash.

6.1 Masat

Masat janë veprimet e propozuara që rrjedhin nga Objektivat e mësipërme. Në shumicën e rasteve Masat e propozuara janë projektuar në mënyrë të integruar për të përmbushur disa objektiva. Masat përmbajnë edhe tregues të performancës për të siguruar ndjekjen e vazhdueshme të zbatimit të tyre.

Masat janë propozuar për periudhën deri në 2030 dhe zbatimi i tyre është parashikuar në tre nivele kryesore:

- Mbi kombëtar, për sa i përket ngritjes së kuadrit të menaxhimit ndërkufitar;
- Kombëtar, për sa i përket mbështetjes drejt ndryshimeve në politika që mundësojnë zbatimin e masave në nivel lokal: dhe
- Lokal, si niveli kryesor i zbatimit.

Masat janë paraqitur në formë tabelore si më poshtë.

OBJEKTIVI	1. PËRMIRËSIMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR DHE QEVERISJES
OBJEKTIVAT SPECIFIKE	1.1 KRIJIMI I MEKANIZMAVE TË DUHURA PËR TË SIGURUAR QË ÇËSHTJET/PROBLEMET PËRKATËSE ME RËNDËSI NDËRKUFITARE TË MERREN NË SHQYRTIM NGA TË DYJA PALËT DHE TË NDËRMERREN VEPRIME TË PËRBASHKËTA
MASAT DERI NE 2030	1.1.1 Hartimi i një marrëveshjeje të përbashkët dhe të pranueshme ndërkufitare bashkëpunimi në fushat e zhvillimit të qëndrueshëm, mbrojtjes së mjedisit dhe menaxhimit të ujërave 1.1.2 Hyrja në fuqi e një mekanizmi menaxhimi të bashkërendimit ndërkufitar për zbatimin e marrëveshjes ndërkufitare të bashkëpunimit, duke përfshirë edhe objektivat e Planit
OBJEKTIVAT SPECIFIKE	1.2 FORCIMI I BASHKËPUNIMIT NËPËRMJET VEPRIMEVE TË PËRBASHKËTA PËR MENAXHIMIN E ZONËS NDËRKUFITARE
MASAT DERI NE 2030	1.2.1 Hartimi programeve të përbashkëta ndërkufitare dhe projekteve përkatëse në bazë të planit të menaxhimit të zonës së Bunës
OBJEKTIVAT SPECIFIKE	1.3 RITJJA E NDËRGJEGJËSIMIT DHE PËRMIRËSIMI I KOMUNIKIMIT TË VLERAVE NATYRORE DHE KULTURORE TË ZONËS SË PLANIT, KËRCËNIMEVE TË MUNDSHME NDAJ SAJ DHE MUNDËSIVE TË ZHVILLIMIT
MASAT DERI NE 2030	1.3.1 Përgatitja e një materiali të përbashkët interpretues për të gjithë zonën e Bunës në lidhje me trashëgiminë natyrore dhe kulturore dhe potencialet e zhvillimit 1.3.2 Organizimi i fushatave për rritjen e ndërgjegjësimit për vlerat natyrore dhe potencialet e zhvillimit të zonës

OBJEKTIVI	2 MBËSHTETJA E NDRYSHIMEVE TË POLITIKAVE NË NIVELE KOMBËTARE
OBJEKTIVAT SPECIFIKE	2.1 NDRYSHIMI DHE/OSE PËRMIRËSIMI I RREGULLOREVE SI EDHE PËRMIRËSIMI I ZBATIMIT TË TYRE
MASAT DERI NE 2030	2.1.1 Shqyrtimi i legjislacioneve kombëtare me rëndësi për menaxhimin e zonës së Bunës dhe identifikimi i zonave për përmirësim; duke u dhënë prioritet fushave/sectorëve të mëposhtëm: <ul style="list-style-type: none"> ▪ përdorimi dhe konsumi ujit ▪ zonat e mbrojtura ▪ peshkimi ▪ gjuetia ▪ menaxhimi i mbetjeve ▪ të drejtat e pronësisë (Shqipëri) ▪ nxjerrja e zavorrit dhe rërës nga shtrati i lumit. 2.1.2 Futja e zonës bregdetare kufizuese/ zonës së ndalimit të veprimtarive gjatë gjithë pjesës së bregdetit me anë të rregulloreve të përshtatshme (në Shqipëri)
OBJEKTIVAT SPECIFIKE	2.2 PËRMIRËSIMI I SISTEMIT TË PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
MASAT DERI NE 2030	2.2.1 Caktimi i standardeve për përgatitjen e dokumenteve të planifikimit hapësinor dhe monitorimin e zbatimit të tyre. 2.2.2 Mbështetja e rehabilitimit të zonave të ndërtuara në mënyrë të paligjshme me cilësi të dobët të mjedisit dhe peizazhit. 2.2.3 Parandalimi i veprimeve të ardhshme që mund të prishin cilësinë e zonave të ndërtuara 2.2.4 Mbështetja e futjes së instrumenteve të politikave të tokës për të shkruajuar shndërrimet e paqëndrueshme të tokës për biznesin e pasurive të paluajtshme.

OBJEKTIVI	3 ZHVILLIMI DHE SHFRYTËZIMI MË I MIRË I BAZËS SË NJOHURIVE PËR MENAXHIMIN E ZONËS NDËRKUFITARE
OBJEKTIVAT SPECIFIKE	3.1 KRIJIMI I MEKANIZMAVE TË VËZHGIMIT PËR TË VLERËSUAR DHE PËRDITËSUAR RREGULLISHT INFORMACIONIN NË LIDHJE ME MJEDISIN E KRIJUAR NGA NJERIU DHE ATË NATYROR
MASAT DERI NE 2030	<p>3.1.1 Përmirësimi dhe harmonizimi ndërmjet dy vendeve- sistemet e monitorimit që kanë të bëjnë me:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Cilësinë e tokës/dheut ▪ Ujin duke përfshirë ujërat sipërfaqësore dhe ujërat e ëmbla nëntokësore ▪ Ujërat detare ▪ Cilësinë e ajrit ▪ Biodiversitetin dhe natyrën, duke përfshirë habitatet dhe llojet me rëndësi për krijimin e rrjeteve kombëtare “Natura” ▪ Proceset e erozionit dhe transporti i sedimenteve ▪ Rreziqet natyrore <p>Përfshirja e të gjitha elementeve të ndryshimeve klimatike në të gjithë komponentët e sistemit të monitorimit.</p>
	3.1.2 Vënia në funksion e sistemit të harmonizuar të vëzhgimit (ndërmjet vendeve) për transformimin e tokës
	<p>3.1.3 Vlerësimi- duke përdorur metodologjitë e harmonizuara- vulnerabilitetin e integruar të zonës për:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Akuiferet (ndotja e tokës, ndërhyrja e ujit të detit, poroziteti i shkëmbinjve, përbërja e dheut, etj.) ▪ Ekosistemet (habitatet, zonat e mbrojtura, etj.) ▪ Përmbytjet ▪ Dherat/fertiliteti ▪ Qëndrueshmëria e tokës ▪ Pyjet ▪ Ndikimet e ndryshimeve klimatike
OBJEKTIVAT SPECIFIKE	3.2 MBËSHTETJA E INTEGRIMIT TË TË DHËNAVE SHKENCORE NË PROCESIN E PLANIFIKIMIT (HAPËSINOR)
MASAT DERI NE 2030	3.2.1 Promovimi i shfrytëzimit të vlerësimeve të vulnerabilitetit si instrument për optimizmin e përdorimit të tokës.
OBJEKTIVAT SPECIFIKE	3.3 PËRMIRËSIMI I KAPACITETEVE NJERËZORE DHE TEKNIKE I ADMINISTRATAVE VENDORE PËR ZBATIMIN E PLANIT
MASAT DERI NE 2030	3.3.1 Organizimi i programeve për ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve lokalë dhe stafit teknik për të mundësuar arritjen e objektivave të Planit.
	3.3.2 Sigurimi i pajisjeve dhe infrastrukturës së nevojshme.

OBJEKTIVI	4 PËRMIRËSIMI I STATUSIT EKOLOGJIK DHE KIMIK I TRUPAVE UJORË
OBJEKTIVAT SPECIFIKE	4.1 PËRMIRËSIMI I CILËSISË SË UJËRAVE TË BRENDSHME SIPËRFAQËSORE DHE ATYRE DETARE
MASAT DERI NE 2030	4.1.1 Sigurimi/ përmirësimi i infrastrukturës së kanalizimeve nëpërmjet ndërtimit të sistemeve të trajtimit të ujërave të ndotura në zonën e Planit, plus edhe në qytetin e Shkodrës.
	4.1.2 Zbatimi i metodave eko-riparuese , plotësuese të Impianteve të Trajtimit të Ujërave të Ndotura për përmirësimin e cilësisë së ujit; këto mund të përfshijnë elementet e mëposhtme (lista nuk është shteruese): ligatinat e ndërtuara, restaurimi i bimësisë bregdetare, metodat e bioinxhinierisë, etj.
	4.1.3 Zbatimi i praktikave më të mira bujqësore.
	4.1.4 Zbatimi i VNM-së tek veprimtaritë që mund të ndikojnë cilësinë e ujit
OBJEKTIVAT SPECIFIKE	4.2 SIGURIMI I DISPONUESHMËRISË SË UJIT ME CILËSI TË MIRË PËR TË GJITHA PËRDORIMET DUKE PËRFSHIRË EDHE EKOSISTEMET DHE PËRDORIMIN DHE KONSUMIN E QËNDRUESHËM TË UJIT
MASAT DERI NE 2030	4.2.1 Mbështetja e ndryshimeve të politikave drejt përdorimit dhe konsumit racional dhe të qëndrueshëm të ujit, kryesisht për ujitje.
OBJEKTIVAT SPECIFIKE	4.3 RUAJTJA E CILËSISË NATYRORE DHE KUSHTEVE HIDROLOGJIKE TË LIGATINAVE TË VOGLA
MASAT DERI NE 2030	4.3.1 Reduktimi i nxjerrjes dhe konsumit të ujit. Reduktimi i humbjeve të ujit në sistemet e shpërndarjes.
	4.3.2 Eksplorimi i dobisë dhe fizibilitetit të përdorimit të ujit jo konvencional të cilësisë së mirë për restaurimin e ligatave dhe rimbushjen e akuifereve, si përdorimi i ujërave të përmytjeve dhe atyre banjatore.
